



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË DATËS 23 QERSHOR 2013

PËRGATITUR NGA KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

TIRANË MË 31 KORRIK 2013



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



Lënda

1. HYRJE

- Metodologjia dhe shtrirja e monitorimit
- Objekti i monitorimit
- Rrugët dhe mjetet për grumbullimin e të dhënave
- Kapacitetet dhe besueshmëria e monitoruesve

2. GJETJET KKYESORE TË PROCESIT PARAZGJEDHOR

- Dekretimi i datës së zgjedhjeve parlamentare dhe ngritja e funksionimi i KOZ-së
- Caktimi i zonave zgjedhore dhe i mandateve
- Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë
- Lajmërimi me shkrim i shtetasve në banesat e tyre
- Lista përfundimtare e zgjedhësve
- Sensibilizimi i zgjedhësve
- Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve
- Caktimi i vendndodhjes së QV dhe i anëtarëve të komisioneve të tyre
- Qendrat e votimit në institucionet e veçanta
- Krijimi i kushteve për akses në QV personave me aftësi të kufizuar
- Fushata zgjedhore
- Situata e rendit dhe qetësisë publike në periudhën parazgjedhore

3. PROCESI I VOTIMIT

- Përgatitjet për procesin e votimit
- Ecuria e procesit të votimit

4. MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

5. TRASPARENCA E PROCESIT ZGJEDHOR

6. KONKLUZIONE

7. ANEKSE

- Raporti i gjetjeve nga FSHDPAK
- Përmbledhje e të dhënave dhe grafikëve mbi gjetjet e KShH.

Shpieguesi i shkurtimeve

| | |
|---------------|---|
| KShH | – Komiteti Shqiptar i Helsinkit, organizatë jofitimprurëse |
| KQZ | – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| KZAZ | – Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve |
| KQV | – Komisioni i Qendrës së Votimit |
| QV | – Qendër Votimi |
| GNV | – Grupi i Numërimit të Votave |
| BE | – Bashkimi Evropian |
| CRD | – Civil Rights Defenders |
| FSHDPK | – Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, OJF |
| KZ | – Kodi Zgjedhor |
| DPGJC | – Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile |
| IEVP | – Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale |

I. HYRJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), që nga viti 1996, ka vëzhguar në mënyrë të vazhdueshme, zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale, sepse mbrojtja dhe respektimi i të drejtës së votës, një nga të drejtat themelore të shtetasve, ka qenë dhe mbetet pjesë e rëndësishme e misionit të tij.

Zgjedhjet janë një moment me rëndësi për zhvillimin demokratik të vendit. Gjatë viteve të tranzicionit, ndonëse janë vërejtur zhvillime pozitive nga zgjedhjet në zgjedhje, përsëri niveli i standardeve demokratike të realizuara në këto procese zgjedhore nuk ka qenë i kënaqshëm dhe gjithmonë ka pasur kritika lidhur me mosplotësimin e standardeve në këtë drejtim.

Zgjedhjet e 23 Qershorit 2013 u zhvilluan në një situatë të rënduar politike, për shkak të marrëdhënieve të acaruar të partive të pozitës me ato në opozitë, gjë që është manifestuar qartë gjatë zhvillimit të legjislaturës së fundit të Kuvendit të Shqipërisë, ku shumë ligje që kërkonin shumicë të cilësuar, mbetën pa u miratuar, por dhe nëpërmjet gjuhës së rëndë, që politikanët kanë përdorur ndaj njeri tjetrit në forume të ndryshme ose përpara publikut të gjerë. Nga ana tjetër vendi ynë në mënyrë të përsëritur morri refuzimin për statusin e vendit kandidat për integrim në BE, ndërkohë që 12 çështjet kyç, të parashtruara për t'u përmbushur nga [BE](#), prej më shumë se 3 viteve, mbetën ende detyra për t'u realizuar, së bashku me detyrën e shtuar së fundmi, që lidhet me zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të drejta, në përputhje me standardet demokratike. Kohët e fundit zgjedhjet e lira e të drejta janë konsideruar nga partnerët ndërkombëtarë si një test i rëndësishëm për aspiratat e Shqipërisë drejt aderimit në Bashkimin Evropian.

Sipas Kushtetutës dhe [KZ](#) në fuqi, sistemi ynë zgjedhor për deputetët e Kuvendit është sistem proporcional rajonal. Janë përcaktuar 12 zona zgjedhore shumë emërore dhe nëpërmjet votimit nga këto zona do të zgjidhen 140 deputetë, të cilët do të dalin nga listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore, të paraqitura, verifikuara e pranuar nga [KQZ](#).

Për realizimin e zgjedhjeve tashmë ekziston një kuadër i plotë ligjor, por duhet theksuar se [KZ](#) pësoi kohët e fundit shumë ndryshime, të cilat kapin rreth 60% të normave të tij. Këto ndryshime u hartuan nga një komision parlamentar bipartizan. Përfundimisht ndryshimet u miratuan në Kuvend më 19.07.2012 me shumicë të cilësuar votash. Vlen të theksohet se me gjithë ndryshimet e shumta që iu bënë [KZ](#), disa nga rekomandimet e OSBE/ODHIR dhe të shoqërisë civile vendase, të pasqyruara në raportet e tyre lidhur me proceset zgjedhore të viteve 2009 dhe 2011, nuk u morën parasysh. Lidhur me amendamentet dhe përmbajtjen e [KZ](#) kritika të shumta u artikuluan dhe nga shumica e partive të vogla, të pozitës e opozitës, të cilat ndihen të penalizuara nga natyra e sistemit zgjedhor që Kushtetuta dhe [KZ](#) kanë sanksionuar. Ndërkohë një sërë përmirësimesh ka pësuar legjislacioni vendas në drejtim të barazisë së shtetasve dhe mbrojtjes nga diskriminimi, gjë që krijon kushte më mbrojtëse për ushtrimin e të drejtës së votës pa diskriminim. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar ka dhe ratifikimi nga ana e shtetit shqiptar, në Dhjetor 2012, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila vendos detyrime të reja lidhur me pjesëmarrjen në votime të të gjithë zgjedhësve me këto veçori.


Në këto zgjedhje u regjistruan si subjekte zgjedhore 66 parti politike dhe dy kandidatë të pavarur, ndërsa zgjedhjet u administruan nga një administratë zgjedhore e përbërë nga tre nivele, ku përfshihen [KQZ](#), si organin më të lartë shtetëror për administrimin e zgjedhjeve; 89 [KZAZ](#); 5.508 [KQV](#); si dhe grupet e numërimit të votave ([GNV](#)). KShH monitoroi përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare të 23 Qershorit 2013, me mbështetjen e Programit të Grandeve të Vogla të Ambasadës Amerikane në Tiranë, Fondacionit SOROS dhe organizatës suedeze [CRD](#)¹. Ajo bashkëpunoi ngushtësisht në këtë monitorim me [FSHDPK](#), një organizatë partnere e specializuar për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

¹ [Organizatë jofitimprurëse suedeze, partnered he donatore e KShH](#)

- METODOLOGJIA DHE SHTRIRJA E MONITORIMIT

Monitorimi i kryer nga KShH përfshin periudhën parazgjedhore, ditën e votimit dhe procesin e numërimit të votave. Për këtë qëllim u kërkua akreditimi dhe u miratuan me vendim të posaçëm nga [KQZ](#)-ja, 172 vëzhgues, afatgjatë dhe afatshkurtër, prej të cilëve rreth 20 vëzhgues u sugjeruan nga organizata partnere [FSHDPAK](#) dhe 10 nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. Fill pas kësaj, u krye me sukses trajnimi i të gjithë vëzhguesve. Më pas ata u pajisën me manualët dhe dokumentacionin e nevojshëm që do t'i ndihmonte për të kryer monitorimin. Nga pikëpamja kohore monitorimi është shtrirë gjatë periudhës Janar – Qershor 2013.

Nëpërmjet stafit të organizatës, korrespondentëve tanë në rrethe dhe me ndihmën e vëzhguesve afatgjatë, kemi kryer një vëzhgim të pjesshëm lidhur me aspektet më të rëndësishme të periudhës parazgjedhore, duke filluar menjëherë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës. Monitorimi i ditës së zgjedhjeve, më 23 Qershor 2013 u krye në **962 QV** (17.62% të totalit të vendit), të shpërndara në 9 qarqe, ose në 75% të totalit të qarqeve të vendit, konkretisht në **Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Fier, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Kukës**. Janë monitoruar, gjithashtu, **6 QV të vendosura në institucione të posaçme**, burgje dhe paraburgime. Nga totali i **QV** të monitoruara 41.27% i përkasin qarkut të Tiranës; 9.56% qarkut të Durrësit; 9.25% qarkut të Elbasanit, 6.03% qarkut të Fierit; 4.57% qarkut të Gjirokastrës, 4.78% qarkut të Korçës; 3.33% qarkut të Kukësit; 11.95% qarkut të Shkodrës dhe 9.25% qarkut të Vlorës. Nga pikëpamja e vendndodhjes 91% e **QV** të monitoruara ndodheshin në territoret e bashkive, ose ndryshe në zonat urbane dhe 9% e tyre në territore të komunave, ose ndryshe në zonat rurale. Siç mund të vihet re qarqet e përzgjedhura shtrihen në të gjithë vendin, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Ato janë përgjithësisht qarqet më të rëndësishme dhe në to banon pjesa më e madhe populatës së vendit.



Përsa i përket procesit të numërimit të votave, të nxjerrjes së rezultateve dhe atij të shqyrtimit të ankimeve, u monitorua në 44% të [KZAZ](#)-ve në rang vendi, ose në 40 [KZAZ](#) nga 89 që ka vendi gjithsej. U monitoruan përkatësisht: në Qarkun Shkodër, [KZAZ](#) nr. 3, 5 dhe 7; në Qarkun Kukës [KZAZ](#) nr. 11; në Qarkun e Durrësit [KZAZ](#) nr. 20, 21, 23, 24 dhe 25; në Qarkun e Tiranës [KZAZ](#) nr. 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40; në Qarkun e Elbasanit [KZAZ](#) nr. 47, 48, 49, 50 dhe 51; në Qarkun e Fierit [KZAZ](#) nr. 59 dhe 60; në Qarkun e Korçës [KZAZ](#) nr. 70, 71 dhe 72; në Qarkun e Gjirokastrës [KZAZ](#) nr. 78 dhe 79; dhe në Qarkun e Vlorës [KZAZ](#) nr. 81, 82, 84, 85 dhe 86. Për monitorimin e procesit të numërimit të votave u aktivizuan 50 vëzhgues, të cilët kryen monitorim të pjesshëm, në aspektin kohor, për shkak të tejzgjatjes së këtyre proceseve, tej afatit të parashikuar në [KZ](#), si dhe për shkak të pamundësisë financiare për vazhdimin e monitorimit.

Procesi i votimit u vëzhgua, në mënyrë specifike, në lidhje me mundësimin e ushtrimit të të drejtës së votës nga zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim u vëzhguan 387 [QV](#) me anë të 163 monitoruesve të akredituar e trajnuar posaçërisht, të cilët ishin bashkëpunëtorë të [FSHDPAK](#) dhe KSHH. Vlen të përmendet se 37 % e vëzhguesve ishin persona me aftësi të kufizuara, ose familjarë të tyre. Këto [QV](#) u monitoruan për të parë mundësimin e ushtrimit të të drejtës së votës nga zgjedhësit me aftësi të kufizuara. [QV](#) e monitoruara u përkisnin katër qyteteve dhe respektivisht Tiranës, ku u vëzhguan 231 [QV](#) ose 59.7% e totalit të [QV](#)-ve të vëzhguara; Elbasanit, ku u vëzhguan 52 [QV](#), ose 13.45% e totalit të [QV](#)-ve të vëzhguara; Shkodrës, ku u vëzhguan 74 [QV](#), ose 19.1% e totalit të [QV](#)-ve të vëzhguara; dhe Durrësit, ku u vëzhguan 30 [QV](#), ose 7.8% e totalit të [QV](#)-ve të vëzhguara.

- OBJEKTI I MONITORIMIT

Objekt i këtij monitorimi ishin disa nga çështjet më të rëndësishme, që i përkasin procesit parazgjedhor; procesi i ditës së zgjedhjeve; dhe procesi i numërimit të votave. Në mënyrë të detajuar bënin pjesë në objektin e monitorimit tonë çështje të tilla si: krijimi i organeve për administrimin e procesit zgjedhor, si [KQZ](#), [KZAZ](#), [KQV](#) dhe funksionimi i tyre; përpunimi dhe publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhore dhe e listës përfundimtare të zgjedhësve; respektimi i afateve të përcaktuara në ligj lidhur me listat dhe publikimin e tyre; korrigjimi i emrave dhe pastrimi i dublimeve të emrave në ekstrakte dhe listën e zgjedhësve; afishimi i ekstrakteve dhe listës së zgjedhësve në vende publike, të dukshme dhe të aksesueshme nga zgjedhësit; njoftimi me shkrim i zgjedhësve në banesat e tyre, sensibilizimi i tyre për të marrë pjesë në votim dhe edukimi i zgjedhësve për mënyrën e votimit; ushtrimi i të drejtës së ankesës ndaj parregullsive në lista; dorëzimi i materialeve zgjedhore pranë [KQV](#); zhvillimi i procesit të votimit më 23 qershor 2013; mundësimi i ushtrimit të të drejtës së votës nga zgjedhësit, qoftë edhe nëpërmjet vendimeve gjyqësore; mundësimi për të ushtruar të drejtën e votës për zgjedhësit me aftësi të kufizuara; administrimi i procesit të zgjedhjeve nga [KQV](#); aksesimi për vëzhguesit e subjekteve zgjedhorë dhe vëzhguesit e pavarur, vendas dhe të huaj; rregulli dhe qetësia në mjediset e [QV](#) dhe përreth tyre; roli i policisë në ruajtjen e rendit dhe qetësisë dhe bashkëpunimi i saj me [KQV](#)-të; mbyllja e votimit dhe shoqërimi i kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore drejt vendit të numërimit të votave; numërimi i votave dhe hartimi i dokumentacionit përkatës.

Në vëzhgimin dhe monitorimin tonë vëmendjen kryesore e përqendruam në respektimin e të drejtës së votës për shtetasit që e gëzojnë atë sipas ligjit, duke mbajtur mirë parasysh jo vetëm se kjo është një nga të drejtat themelore të shtetasve, e sanksionuar në Kushtetutë, por edhe se në një vend demokratik, nëpërmjet ushtrimit të votës, shtetasit ushtrojnë direkt sovranitetin e tyre dhe gjenerojnë organet e pushtetit shtetëror.

- RRUGËT DHE MJETET PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE

Informacioni që serviret në këtë raport është rezultat i konstatime të vërejtura drejtpërsëdrejti në terren nga vëzhguesit tanë të akredituar, janë fakte të marra nëpërmjet bisedave me personat përgjegjës, si dhe nga këqyrja e të dhënave zyrtare të publikuara nga autoritetet përkatëse. Për ta grumbulluar këtë informacion janë organizuar vizita, me ekipe pune, në 9 qarqet e sipërshtënuara, bazuar në një tematike të parapërgatitur, e cila u është vënë në dispozicion korrespondentëve të KShH në rrethet dhe vëzhguesve afatgjatë, për ta pasur si orientim në veprimtarinë e tyre vëzhguese. KShH ka ndjekur me vëmendje edhe pasqyrimin e situatës parazgjedhore e zgjedhore nga mediet e shkruara dhe elektronike. Në këtë raport kemi përfshirë, në ndonjë rast, edhe informacionin mediatik të gjithpranuar, ose të verifikuar në terren nga stafi ose bashkëpunëtorët tanë.

Për grumbullimin e informacionit në lidhje me aksesin që u ofrohej zgjedhësve me aftësi të kufizuara gjatë procesit zgjedhor, u përdor një pyetësor specifik, me 13 pyetje të mbyllura. Pyetësori u përgatit

nga stafi i organizatës partnere [FSHDPAK](#), organizatë e specializuar për mbrojtjen e të drejtave të këtij komuniteti.

- **KAPACITETET DHE BESUESHMËRIJA E MONITORUESVE**

Stafi i KShH, korrespondentët dhe vëzhguesit afatgjatë e afatshkurtër, përveç përvojës së tyre shumëvjeçare për monitorimin e zgjedhjeve, i janë nënshtruar edhe një trajnimi profesional, me qëllim për t'u njohur më mirë me standardet demokratike e kushtetuese që lidhen me standardet e zgjedhjeve të lira e të ndershme, me dispozitat e Kodit Zgjedhor, me Udhëzimet e [KQZ](#)-së në fuqi, si dhe me qëllimin e objektivat e organizatës për këtë monitorim. Vëzhguesit afatgjatë e afatshkurtër janë mbajtur në kontakt nga stafi i KShH-së, gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, si dhe u janë dhënë, herë pas here, udhëzimet e nevojshme për ndjekjen e çështjeve të konstatuara në terren. Raporti përfundimtar dhe konkluzionet janë përpunuar, mbi bazën e materialeve të prezantuara prej grupeve të vëzhguesve, nga një grup pune i specializuar i KShH, nën drejtimin e Drejtores Ekzekutive të organizatës.

II. **GJETJET KRYESORE TË PROCESIT ZGJEDHOR**

Standardet e Kopenhagenit theksojnë se shtetet palë duhet të sigurojnë që ligji dhe sistemi politik vendas duhet të mundësojnë kryerjen e fushatave elektorale në një atmosferë korrekte e të lirë, në të cilën as masat administrative, as dhuna, as presioni nuk do t'i pengojnë partitë ose kandidatët që të shprehin lirisht opinionet e tyre dhe pozicionet, si dhe nuk do të ndalojnë zgjedhësit të njohin e të diskutojnë, ose për të dhënë votën e tyre pa frikën e persekutimit. Këto standarde kanë qenë pika jonë e referimit si gjatë monitorimit në terren ashtu dhe gjatë hartimit të këtij raporti, sepse ato janë parametrat që i përkasin mënyrës së funksionimit të shtetit dhe shoqërisë demokratike, veçanërisht për zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. Ato përbëjnë bazën e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverisjeje që lind nga procesi zgjedhor.

- **DEKRETIMI I DATËS SË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE DHE NGRITJA E FUNKSIONIMI I [KQZ](#)**

Presidenti i Republikës, në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor, me dekretin nr. 7841, datë 03.12.2012, përcaktoi se zgjedhjet për Kuvendin e ri të Shqipërisë do të mbaheshin më 23 Qershor 2013. Ndërkohë Kuvendi kishte miratuar, më 19.07.2012, me shumicë të cilësuar votash ndryshime të rëndësishme në [KZ](#). Përfundimisht mund të themi se për realizimin e zgjedhjeve ekzistonte një kuadër i plotë ligjor, por ndryshimet e shumta që pësoi [KZ](#) (rreth 60% të normave të tij) nuk u shoqëruan me kohën e duhur në dispozicion të specialistëve dhe anëtarët e organeve të administrimit zgjedhor, për ta studiuar e kuptuar mirë këtë ligj të rëndësishme.

Nga monitorimi i mbledhjeve të Kuvendit të Shqipërisë, i mbledhjeve të [KQZ](#)-së dhe informacioni i pasqyruar në media për këtë qëllim, u konstatua se [KQZ](#) u konstituua dhe filloi veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor në fuqi, por lidhur me këtë organ nuk u mbajtën parasysh rekomandimet e OSBE/ODHIR për depolitizimin e tij dhe të administratës zgjedhore në përgjithësi. Si pasojë edhe në këto zgjedhje u konstatua se [KQZ](#), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet, sërish ka manifestuar polarizim të qëndrimeve të anëtarëve, të cilët shpesh përqasën qëndrimet e tyre me qëndrimet e partive politike parlamentare, që i kishin propozuar për të marrë atë funksion. Roli i [KQZ](#)-së në procesin zgjedhor është i rëndësishëm, sepse ai është organi më i lartë shtetëror, i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve. Vendimmarrja e njëanshme dhe pa konsensus, në disa raste,

e këtij organi cenoi besimin e publikut dhe të subjekteve zgjedhore ndaj veprimtarisë së tij. Kjo dëmtoi rëndë dhe në mënyrë të pariparueshme, disa faza të rëndësishme të procesit zgjedhor, si ndarja e mandateve për zonat zgjedhore, shqyrtimin e ankesave, certifikimin e zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve sipas rezultatit zgjedhor etj.

Anëtarët e [KQZ](#)-së, megjithëse propozohen nga partitë politike të shumicës dhe opozitës parlamentare, përfundimisht zgjidhen nga Kuvendi dhe më pas bëjnë betimin përpara këtij organi. KShH mendon se, ashtu siç përcakton [KZ](#) anëtarët e [KQZ](#) janë të detyruar që gjatë ushtrimit të detyrës së tyre të veprojnë në mënyrë të pavarur, duke zbatuar vetëm ligjin. Në këtë kontekst kemi shprehur publikisht mendimin se nuk duhet ti ndërpritej mandati, para kohe, anëtarit të [KQZ](#)-së të propozuar nga Partia LSI dhe i emëruar rregullisht nga Kuvendi. Pas kësaj tre anëtarë të tjerë të [KQZ](#)-së dhanë dorëheqjen, duke e reduktuar numrin e anëtarëve të këtij organi në 4, nga 7 që parashikon ligji. Zëvendësimi i njëanshëm i një anëtari të [KQZ](#) dhe dorëheqja e tre anëtarë të tjerë, si dhe mos gjetja e konsensusit politik e ligjor për zëvendësimin e tyre, ka shkaktuar një situatë jonormale për këtë organ të rëndësishëm, duke e bërë të pamundur ligjërisht marrjen e vendimeve, që kërkojnë një kuorum dhe shumicë të cilësuar, me jo më pak se 5 anëtarë, ose jo më pak se 5 vota. [KQZ](#)-ja vazhdoi të funksionojë me 4 anëtarë deri në përfundim të procesit zgjedhor, për shkak se Kuvendi i Shqipërisë nuk bëri plotësimet e nevojshme. Kjo u shoqërua me pasoja të dëmshme lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe arritjen e standardeve demokratike në këtë proces zgjedhor.

KShH mendon se [KQZ](#) nuk mund të jetë organ politik dhe bipartizan, siç janë shprehur funksionarë të lartë politikë të Kuvendit, të Qeverisë, ose përfaqësues të klasës politike, sepse kjo do të bënte të pamundur vendimmarrjen e tij, ashtu siç dhe ka ndodhur realisht gjatë këtij procesi zgjedhor.

Bllokimi institucional i [KQZ](#)-së është veçanërisht i dëmshëm dhe përbën një precedent negativ, në kushtet kur për miratimin akteve të rëndësishme normative, në kundërshtim me ligjin, vendimet u miratuan me 4 vota. Këtu i referohemi në mënyrë të veçantë vendimeve lidhur me përdorimin e teknologjisë për identifikimin e zgjedhësve në Qarkun e Tiranës dhe të teknologjisë për numërimin dhe vlerësimin të votave për qarkun e Fierit, vendimet që lidhen me shqyrtimin e ankimeve ndaj rezultatit zgjedhor, si dhe vendimit nr. 503, datë 03.06.2013 "*Për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në radiotelevizionin privat bazuar në materialet e vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore*" etj. Gjatë veprimtarisë së tij ky organ ka manifestuar, në disa raste, qëndrime të njëanshme dhe të politizuara, si p.sh në kuadër të miratimit të numrit të zonave zgjedhore dhe mandateve për secilën prej tyre. Pozicionimi politikisht i anëtarëve të [KQZ](#) krijoi pamundësi vendimmarrjeje dhe si pasojë dy çështjet e para u zgjidhën, përkatësisht, nga Kolegji Zgjedhor dhe Kuvendi i Shqipërisë. Përsa i përket vendimit "*Për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në radiotelevizionin privat bazuar në materialet e vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore*" ai është kritikuar, si jo ligjor, si nga vëzhguesit ndërkombëtarë, ata vendas, përfshi dhe KShH-në. [KQZ](#) ka marrë edhe vendime të tjera, që nuk mbështeten në ligj dhe në standardet demokratike të zgjedhjeve. Të tilla përmendim vendimi nr. 271, datë 25.04.2013, vendimi nr. 426, datë 17.05.2013, vendimi nr. 445, datë 20.05.2013, vendimi nr. 446, datë 20.05.2013, vendimi Nr. 529, datë 8.6.2013, etj., të cilët sipas ligjit duhej të merreshin me 5 vota pro. Mendojmë se është e gabuar që në ndonjë rast problemet u zgjidhën politikisht duke anashkaluar sanksionimet ligjore. Kjo vjen në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës.

KShH mendon se plotësimi i [KQZ](#) me 7 anëtarë ishte një domosdoshmëri për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këtij organi, si dhe për të rritur besimin e zgjedhësve në lidhje me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, zhvillimin e tij në përputhje me ligjin e standardet demokratike.

- CAKTIMI I ZONAVE ZGJEDHORE DHE I MANDATEVE

Propozimi për ndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore është një nga kompetencat e [KQZ](#)-së, sanksionuar nga neni 21/5 i Kodit Zgjedhor. Ky proces, që duhet të kryhej jo më vonë se 6 muaj përpara përfundimit të mandatit të Kuvendit, është shoqëruar me debate të shumta për shkak se [KQZ](#) dështoi në marrjen e një vendimi me shumicë të cilësuar votash, siç e parashikon ligji. Kuvendi e morri në shqyrtim këtë çështje dhe shpërndau mandatet për çdo zonë zgjedhore duke u bazuar në statistikat e papërditësuara të popullsisë, duke ruajtur skemën e ndarjes së mandateve, të përdorur në zgjedhjet e vitit 2009.

Në botimin “*Kodi i Praktikave më të mira për Çështjet Zgjedhore*”, të miratuar nga Komisioni i Venecias, në vitin 2002, midis të tjerave thuhet se *vota e çdo votuesi duhet të ketë të njëjtën vlerë dhe të njëjtën fuqi në përcaktimin e rezultatit të zgjedhjeve*. Për këto arsye, por jo vetëm, ndarja e mandateve për çdo zonë zgjedhore detyrimisht është e lidhur me numrin e zgjedhësve dhe të shtetasve, që ajo zonë ka realisht, prandaj duhej të mbahej mirë parasysh çdo ndryshim demografik që ka ndodhur në periudhën ndërmjet dy zgjedhjeve. Nga ana tjetër edhe Kodi ynë Zgjedhor ka përcaktuar² se: “*Numri i mandateve të çdo zone zgjedhore përcaktohet në raport me numrin e shtetasve të secilës zonë zgjedhore.*”, ndërsa në nenin 76, pika 3, në mënyrë eksplicite sanksionohet se “*...Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk rishikohet në rastin e zgjedhjeve të parakohshme*”, duke nënkuptuar se në rastet e tjera rishikimi i shpërndarjes së mandateve është i detyrueshëm.

KShH ka shprehur mendimin e tij lidhur me këtë çështje, nëpërmjet një deklaratë për shtyp, duke theksuar se përcaktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore është proces, që veç sa më sipër, lidhet edhe me parimin e barazisë së votës. Në nenin 45 të Kushtetutës sanksionohet se “*Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*”. Me votë të barabartë kuptojmë mundësinë e barabartë të shtetasve për ushtrimin e të drejtës së votës, si dhe të njëjtën vlerë, ose peshë të secilës votë të dhënë nga zgjedhësit, në përcaktimin e rezultatit zgjedhor.

Në të njëjtën kohë KShH me deklaratën e tij u ka tërhequr vëmendjen e deputetëve të Kuvendit, me qëllim që në vendimin e tyre për ndarjen e mandateve të mos lejonin trajtime diskriminuese për shkaqe politike, etnike, gjinore, gjuhësore, fetare, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual të grupeve të shtetasve që përbëjnë popullatën e zonave zgjedhore, apo kufizime të tjera që vijnë në kundërshtim me angazhimet ligjore e konventore, të marra përsipër në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi.

- EKSTRAKTET E PËRBËRËSVE ZGJEDHORË

Për procesin zgjedhor dhe zgjedhësit, në veçanti, përgatitja dhe publikimi i listave zgjedhore është me shumë rëndësi. Në këtë proces ekstraktet e përbërësve zgjedhorë janë dokumente të rëndësishme sepse ato shërbejnë si bazë zyrtare për verifikimin e përfshirjes së zgjedhësve në listën përfundimtare të zgjedhësve dhe ju garanton atyre mundësinë e ushtrimit të votës. Nga ana tjetër parregullsitë e konstatuara në ekstrakte mund të korrigjohen më lehtësisht, nëpërmjet një ankese administrative, gjë që është më e thjeshtë për shtetasit, në raport me ankimin gjyqësor, i cili ka procedura më të gjata e më formale.

Në nenin 51 të [KZ](#) parashikohet detyrimi i zyrave të gjendjes civile që, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, të printojnë dhe të publikojnë ekstraktet e përbërësve zgjedhorë. Publikimi duhet të bëhet jo më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve (*dt. 3 Janar 2013*) dhe do të duhej të përsëritej periodikisht çdo 30 ditë, deri në shpalljen e listës përfundimtare të zgjedhësve. Publikimi, sipas dispozitës së mësipërme bëhet: “*... në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun*”. Duke qenë se në [KZ](#) parashikohet se listat e zgjedhësve shpallen jo më

² Shih nenin 75 të Kodit Zgjedhor

vonë se data 19 Maj 2013, ekstraktet e përbërësve zgjedhorë duhet të publikoheshin edhe 4 herë të tjera, në datat. 3 Shkurt, 3 Mars, 3 Prill dhe 3 Maj 2013.

Nga vëzhgimet në terren të KShH³ ka rezultuar se publikimi i ekstrakteve filloi me vonesë, ose publikimi i tyre nuk u bë sipas mënyrës së parashikuar nga [KZ](#), veçanërisht në Tiranë, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan dhe Shkodër. Problematike u paraqit gjendja në disa komuna të vëzhguara si p.sh. Komuna e Pustec (qarku Korçë), fshati Baltëz (qarku Fier), Komuna Qendër (qarku Vlorë), etj, ku edhe shumë kohë më pas afatit ligjor, pavarësisht se përfaqësuesit e institucioneve vendore na deklaruan se ekstraktet ishin publikuar, praktikisht nga vëzhgimi në terren dhe komunikimi me banorët kjo nuk rezultoi e vërtetë. Për pasojë, konstatoam se zgjedhësit, masivisht, nuk kishin informacion rreth ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, gjë që u vu re dhe nga ankesat e pakta administrative që ata parashtruan për të bërë korrigjimet e nevojshme në to.

Për sa i takon detyrimin të zyrave të gjendjes civile për publikimin periodik, çdo muaj të ekstrakteve, deri në shpalljen e listave përfundimtare të zgjedhësve, KShH ka konstatuar se në përgjithësi publikimi është bërë vetëm një ose dy herë, ndryshe nga sa parashikon [KZ](#). Përgjegjësit e zyrave të gjendjes civile, në shumicën e rrethëve të monitoruara, deklaruan se kishin pasur mungesa ose pamjaftueshmëri të mjeteve të nevojshme logjistike për printimin e ekstrakteve, si p.sh bojë, letër dhe printera. Për të plotësuar këto nevoja, në disa raste, si në Qarkun Elbasan, zyrave të gjendjes civile u kishin ardhur në ndihmë njësitë e pushtetit vendor, që u kishin vënë në dispozicion burimet e tyre materiale e teknike, ose kishin akorduar fonde të veçanta nga buxhetet e tyre, me qëllim blerjen e mjeteve logjistike të nevojshme.

Zyrat e gjendjes civile na deklaruan se faktikisht ekstraktet përgatiteshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ([DPGJC](#)) dhe u dërgoheshin vetëm për t'u publikuar. Sipas tyre, ekstraktet e përbërësve zgjedhorë ishin gjeneruar me vonesë nga [DPGJC](#) dhe jo aq herë sa e kërkonte ligji. Ky fakt u verifikua lehtësisht edhe nga vëzhguesit e KSHH, sepse ekstraktet mbanin datën e printimit.

Mënyra e afishimit të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, në disa raste, linte për të dëshiruar. Shtetasit nuk kishin akses të lirë në shkollat ku ekstraktet ishin afishuar, ose afishimi ishte bërë në mjedise që nuk frekuentoheshin shpesh nga banorët zgjedhës, ndërkohë që nuk i gjetëm të afishuara ekstraktet pranë zyrave të gjendjes civile, siç përcakton neni 51 i [KZ](#). Në shumë raste afishimi ishte bërë në distancë të tillë që ishte e pamundur të konsultoheshin me sy të lirë nga shtetasit. Si rast të veçantë pozitiv, lidhur me këtë çështje, mund të përmendim Bashkinë e Vlorës e cila e kishte vendosur listën me ekstraktet e përbërësve zgjedhorë në një faqe në internet, me qëllim që zgjedhësit të mund ta konsultonin atë online. Bazuar në sa më sipër KSHH mendon se [KZ](#) duhet të përmirësohet në të ardhmen edhe në drejtim të procedurës për hartimin dhe publikimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, duke parashikuar dhe sanksione për subjektet që u caktohen detyra në këtë drejtim, nëse nuk i përmbushin ato në përputhje me ligjin.

Një nga pasaktësitë e konstatuara në lidhje me ekstraktet e përbërësve zgjedhorë ishte dublimi i një numri të konsiderueshëm të emrave të zgjedhësve. Lidhur me këtë shqetësim janë shprehur shpesh edhe mediet e shkruara, ose elektronike, por dublimet janë konstatuar edhe nga vëzhguesit e KShH, veçanërisht në Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Durrës.

Ky shqetësim ka përbërë objekt diskutimi në [KOZ](#), por për fat të keq mbledhjes iu paraqitën për shqyrtim nga auditet materiale që e paraqitnin situatën në mënyrë tepër të diferencuar, gjë që shkaktoi trajtimin e çështjes në mënyrë bipartizane. Më pas, gjatë procesit shumica e rasteve të dublimeve janë pastruar nga administrata përkatëse publike. Megjithatë, KShH shpreh shqetësim për mungesën e një

³ Për këtë qëllim janë kryer misione vëzhgimi në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë e Gjirokastrë.

dokumentacioni të saktë, e të pakontestueshëm lidhur me numrin dhe emrat e shtetasve me të drejtë vote në vendin tonë, sepse konstatohet se një pjesë e këtyre dublimeve janë të mbartura nga zgjedhjet e kaluara. Nga ana tjetër jemi të mendimit se puna për pastrimin e tyre duhet të vazhdojë, pa ndërprerje dhe jo vetëm në periudha zgjedhore.

Një problematikë tjetër e referuar nga zyrat e gjendjes civile dhe njësitë vendore në rrethet Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Gjirokastrë etj. kishte të bënte me mungesën e specifikimit të kodit të banimit në ekstrakte për një numër të madh zgjedhësish. Kjo dukuri u mbart edhe në përmbajtjen e listës përfundimtare të zgjedhësve, kur ajo u bë publike.

- LAJMËRIMI ME SHKRIM I SHTETASVE NË BANESËN E TYRE

Në nenin 52 të [KZ](#) parashikohet se brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë (d.m.th brenda datës 3 Mars 2013), kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës, që banon në territorin ku ai shtrin juridiksionin dhe e njofton atë për përfshirjen në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, si dhe për [QV](#) ku duhet të votojë. Shpenzimet për njoftimin, sipas këtij neni, në ligj përcaktohet se mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile (d.m.th Ministria e Brendshme). Gjithashtu ligji parashikon që fondi përkatës u shpërndahet njësitë të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka çdo njësi vendore.

Nga monitorimi dhe takimet me përfaqësuesit e njësitë të qeverisjes vendore rezultoi se pothuajse në të gjitha rrethet njoftimi i zgjedhësve nuk është realizuar brenda afatit kohor të parashikuar nga ligji dhe në asnjë rast, këtyre organeve nuk u është dhënë nga Ministria e Brendshme fondi i nevojshëm për realizimin e këtij njoftimi. Megjithatë konstatuam se njoftimi i shtetasve është realizuar në disa njësi vendore, të cilat kanë përdorur për këtë qëllim fondet e tyre, por gjithsesi procesin e kanë kryer tej afateve dhe procedurës të parashikuara në ligj. Organet e pushtetit vendor, që kanë plotësuar këtë detyrimin ligjor, na informuan se për të kryer njoftimin kanë përdorur herë stafin e tyre dhe herë persona të tjerë, të papaguar, si p.sh personat që përfitojnë mbështetje sociale nga pushteti vendor, ose vullnetarë, të cilët në asnjë rast nuk ishin në gjendje të provonin dhe dokumentonin punën e bërë, sikundër kërkohet nga [KZ](#).

- LISTA PËRFUNDIMTARE E ZGJEDHËSVE

Edhe lista përfundimtare e zgjedhësve u shpallën me vonesë. Sipas vëzhgimit tonë në 9 qarqe të vendit, rezultoi se listat përfundimtare të zgjedhësve janë shpallur me disa ditë vonesë, konkretisht pas datës 21 maj 2013. Megjithatë duhet të nënvizojmë se lista u bë publike nga [KOZ](#) dhe Ministria e Brendshme, në formë elektronike, brenda afatit ligjor.

Bërja publike e listave përfundimtare të zgjedhësve është detyrim i rëndësishëm ligjor. Nga përmbajtja e nenit 56 të [KZ](#) rezulton se zyra e gjendjes civile i dërgon [KZAZ](#)-së, në tre kopje, listën përfundimtare të zgjedhësve jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve. [KZAZ](#)-ja, sipas rastit, publikon listën pranë qendrës përkatëse të votimit, në një ambient me akses të lirë për zgjedhësit, si dhe i dërgon [KQV](#)-së kopjen e saj të listës për përdorim gjatë votimit.

Vonesat e shpalljes së listave përfundimtare rezultoi të kishte ndodhur për një sërë arsyesh si: mos dërgimi i listave brenda afatit ligjor nga ana e zyrës së gjendjes civile tek [KZAZ](#)-të përkatëse, siç ka ndodhur në disa [KZAZ](#) të Tiranës; ose për shkak të mosfunksionimit të disa [KZAZ](#)-ve, për shkak se nuk ishte plotësuar ende numri i anëtarëve të tyre, siç ka ndodhur në [KZAZ](#)-të e Fierit; ose për shkak të largësisë midis [KZAZ](#)-së dhe qendrave të votimit, siç ka ndodhur në [KZAZ](#)-të e Kukësit, etj. Pjesa më e madhe e listave përfundimtare janë vendosur në ambiente të mbrojtura dhe të aksesueshme nga shtetasit, por ka pasur raste kur listat përfundimtare të zgjedhësve janë pozicionuar në lartësi, që nuk mundësonte leximin e tyre me sy të lirë, ose janë vendosur brenda ambienteve publike, kryesisht

institucione arsimore, të cilat në orët e pasdites ishin të mbyllura dhe të pa aksesueshme nga publiku. Konkretisht kjo u vu re në qarqet Korçë, Vlorë, Kukës, Fier, Tiranë, Durrës etj.

Një problematikë e referuar nga Bashkia e Sarandës kishte të bënte me pasaktësitë e emërtimeve të qendrave të votimit në listat përfundimtare të zgjedhësve, duke përbajtur kështu emërtimet e vjetra të objekteve ku ishin vendosur Qendrat e Votimit, gjë që ka shkaktuar konfuzion tek anëtarët e [KZAZ](#)-së dhe tek zgjedhësit, si dhe vonesë në publikimin e listave përfundimtare përkatëse.⁴

Problemi i adresës së pasaktë të [QV](#)-së u konstatua për shumë zgjedhës të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve, veçanërisht në ato raste kur [QV](#)-të ishin vendosur në objekte private. Shpesh në këto raste në kolonën e adresës së [QV](#) shënohej emri i pronarit dhe jo adresa e objektit. Kjo i çorientoi zgjedhësit përkatës ditën e votimit.

Për t'u ardhur në ndihmë zgjedhësve, që për arsye të ndryshme nuk e gjenin emrin në listën e zgjedhësve, KSHH përgatiti një formular tip, që u shpërnda falas dhe shërbeu për t'iu drejtuar gjykatës, e për të kërkuar ushtrimin e të drejtës së votës. Megjithatë, saktësimi i mëtejshëm i listës së zgjedhësve është një çështje që duhet të mbahet mirë në konsideratë për zgjedhjet e ardhshme sepse, përfshirja e zgjedhësit në këtë listë, me emër e adresë të saktë, është një nga kushtet e rëndësishme ligjore që kushtëzon ushtrimin e të drejtës së votës.

- SENSIBILIZIMI I ZGJEDHËSVË

Gjatë kësaj periudhe parazgjedhore KSHH dhe organizata partnere [FSHDPAK](#) zhvilluan veprimtari për sensibilizimin dhe edukimin e qytetarëve në lidhje me pjesëmarrjen në votim dhe mënyrën e votimit, duke u ndalur veçanërisht tek komuniteti rom, personat me aftësi të kufizuara, pakicat kombëtare dhe të rinjtë që votonin për herë të parë. Nga ana tjetër, konstatoam se [KQZ](#)-ja nuk zbatoi sa e si duhet detyrën e saj për edukimin ligjor të zgjedhësve, siç parashikohet në nenin 21, pika 9 e Kodit Zgjedhor. Ky organ u limitua vetëm me miratimin e një strategjie për këtë veprimtari dhe publikimin e një spoti publicitar, disa ditë para datës së zgjedhjeve.

Nga takimet me qytetarë dhe përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore, KSHH vërejti se interesimi i zgjedhësve për t'u njohur me ekstraktet e përbërësve dhe listat përfundimtare të zgjedhësve ishte i ulët. Ky fenomen është rezultat i situatës së përgjithshme parazgjedhore, që është karakterizuar më një farë kaosi dhe nga vonesa të shumta në plotësimin e detyrimeve ligjore. Vëmë në dukje se është krijuar dhe një traditë negative, sipas së cilës shtetasit fillojnë interesimin për përfshirjen në lista të zgjedhësve vetëm ditët e fundit para zgjedhjeve. Për këto arsye rritet nevoja për veprimtari edukuese dhe informuese gjatë fazës përgatitore të zgjedhjeve. KSHH dhe organizata partnere [FSHDPAK](#) kanë zhvilluar veprimtari për sensibilizimin dhe edukimin e zgjedhësve në 9 qarqet e përfshira në nismat e tyre. Përveç takimeve të drejtpërdrejta me zgjedhës janë përdorur dhe bisedat në TV lokale e nacionale, si dhe mediet e shkruara. [FSHDPAK](#) prodhoi e transmetoi një spot sensibilizues për zgjedhësit me paaftësi të ndryshme.

Në këto zgjedhje veprimtaritë informuese dhe sensibilizuese në favor të të zgjedhësve janë mbuluar kryesisht nga ofj-të, projektet e të cilave u financuan nga Ambasada Amerikane në Tiranë, Fondacioni SOROS dhe organizata suedeze [CRD](#).

Nga informacionet e marra pranë njësive të pushtetit vendor, rezultoi se, si pasojë e indiferencës së shtetasve, kërkesat për ndryshimin e përbërësve zgjedhorë ishin të pakta, megjithatë pushteti vendor

⁴ Shih listën zyrtare të [KQZ](#) për vendndodhjen e [QV](#)-ve

dhe zyrat e gjendjes civile janë angazhuar, qoftë dhe kryesisht, në vazhdimësi për pastrimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë nga dublimet e emrave, nga personat e vdekur, si dhe për saktësimin e adresave të zgjedhësve.

- NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I [KZAZ-VE](#)

Ngritja dhe mirëfunksionimi i organeve të administrimit të zgjedhjeve, e të gjitha niveleve, është një element i rëndësishëm për mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Nga monitorimi rezultoi se [KZAZ](#)-të u ngritën dhe zhvilluan mbledhjet e konstituimit të tyre, përgjithësisht, në fund të muajit Mars 2013. Megjithatë për shkak të ndryshimit të përbërjes së koalicionëve të subjekteve zgjedhore dhe të kërkesave të vazhdueshme të tyre, për motive të paqarta, [KOZ](#) kreu në vazhdimësi zëvendësime të anëtarëve të [KZAZ-ve](#), deri ditën e fundit para zgjedhjeve, në disa raste pa patur bazë ligjore të qartë, ose kërkesë të legjitimuar nga subjektet zgjedhore që e kërkonin ndryshimin. Zëvendësime të tilla janë kryer në [KZAZ](#)-të e qarqeve Tiranë, Korçë, Lezhë, Elbasan, Fier, Kukës, Vlorë, Durrës e Shkodër etj.

Nga 31 [KZAZ](#) të monitoruara, 14⁵ prej tyre deklaruan se funksiononin në mënyrë të rregullt dhe zhvillonin mbledhje në mënyrë periodike. Në 6 [KZAZ](#)⁶ ishte i pamundur kontaktimi i anëtarëve për shkak të mos prezencës së vazhdueshme të tyre në ambientet ku duhet të ushtronin funksionin. Ndonëse vëzhguesit tanë shkuan rregullisht pranë zyrave të këtyre [KZAZ-ve](#) në datat. 4-5 Qershor, u informuam nga burimeve të tjera⁷ se prej disa ditësh këto zyra nuk frekuentoheshin nga anëtarët e tyre, ndonëse këto organe duhet të mblidheshin çdo ditë, sipas ligjit. Si pasojë edhe trajnimi i anëtarëve të [KZAZ-ve](#) u realizua përtej afatit kohor të përcaktuar në [KZ](#). Trajnimi i anëtarëve të [KZAZ-ve](#) që u emëruan ditët e fundit para zgjedhjeve nuk u krye.

KShH mendon se trajnimi i anëtarëve të [KZAZ-ve](#) dhe strukturave të tjera zgjedhore është me shumë rëndësi, aq më tepër kur baza ligjore për zhvillimin e administrimit të zgjedhjeve pësoi shumë ndryshime, të cilat, siç kemi përmendur më lart zënë rreth 60% të përmbytjes. Për pasojë kemi vërejtur se funksionimi i [KZAZ-ve](#) në disa raste ka lënë për të dëshiruar dhe anëtarët e këtyre organeve nuk dispononin informacion të mjaftueshëm për kompetencat dhe detyrat që duhej të kryenin. Në disa [KZAZ](#), gjatë takimeve që patëm me anëtarët e tyre, na u parashtrua shqetësimi se nuk ishin pajisur në kohë nga [KOZ](#) me listat dhe adresat e qendrave të votimit. Në [KZAZ](#)-të e Tiranës, e të Vlorës na u ankuan për mos mbritjen e pajisjeve të zyrave, ndërsa në Fier na u referua mungesa e informacion të saktë për ambientet ku do të vendosej kjo [KZAZ](#), pasi zyrat për ta u caktua me vonesë, duke penguar kështu zhvillimin e veprimtarisë së rregullt të [KZAZ-ve](#) përkatëse.

- CAKTIMI I VENDNDODHJES SË QV-VE DHE I ANËTARËVE TË TYRE

Kodi Zgjedhor⁸, përcakton se kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore caktojnë dhe shpallin vendndodhjen e [QV](#), që do të funksiononin brenda juridiksionit territorial të tyre, jo më vonë se 30 ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve dhe se brenda 10 ditëve duhej të njoftonin [KOZ](#)-në, e cila përditëson hartën e përgjithshme të qendrave të votimit. Lidhur me përcaktimin e vendndodhjes së [QV-ve](#) [KZ](#) solli ndryshime, duke përcaktuar se numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë

⁵ [KZAZ](#)-të 5, 6, 7, 11, 24, 28, 33, 35, 36, 38, 39, 50, 51, 60, 71, 78, 79 dhe 82.

⁶ [KZAZ](#)-të 32 dhe 37 në Tiranë dhe 83, 84, 85, 86 në Vlorë

⁷ Me anë të kontaktimit të personave përgjegjës për ruajtjen e objekteve ku ishin vendosur zyrat e këtyre [KZAZ-ve](#)

⁸ Neni 62 [KZ](#)

më i vogël se 200 dhe jo më i madh se 1.000 zgjedhës. Ky ndryshim ligjor solli rritjen e numrit të [QV](#) në vend, duke e çuar numrin total në 5.508, por njëkohësisht lehtësoi shumë procesin e votimit dhe eliminoi radhët e gjata. Mungesa e ambienteve publike të përshtatshme për këtë numër të [QV](#)-ve shkaktoi rritjen e propozimeve në [KQZ](#) për vendosjen e tyre në objekte private. Si rezultat [KQZ](#) miratoi që rreth 500 [QV](#) (gati 10% e totalit të tyre) që të instaloheshin në mjedise private. Një pjesë e këtyre vendimeve u morën me vonesë dhe për pasojë në qarqet Durrësit, Fierit dhe Vlorë u vonua publikimi i listave të zgjedhësve, të cilat duhet të përmbanin dhe adresën përkatëse të qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Vendosja e [QV](#) në mjedise private, me vendim të [KQZ](#), ka qenë një aspekt, që në disa raste, ka hasur kundërshtim. Kolegji Zgjedhor ka anuluar vendimin e [KQZ](#)-së, duke i konsideruar jo në përputhje me ligjin caktimin e [QV](#)-ve në disa mjedise private.

Gjatë takimeve me përfaqësues të prefekturave dhe të njësive të qeverisjes vendore, veçanërisht në komuna, na u referuan disa vështirësi që u janë krijuar shtetasve për ushtrimin e të drejtës së votës, për shkak të detyrimit ligjor për shkrirjen e [QV](#) që kanë më pak se 200 zgjedhës dhe transferimin e zgjedhësve të këtyre komunave në qendrën më të afërt të votimit⁹. Ky shqetësim u parashtrua në komunën e Pustecit, në Rrethin e Korçës, Komunën Gracen, në Rrethin e Elbasanit dhe Komunën Stëblevë, në Rrethin e Librazhdit. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, ose përfaqësuesit e prefekturave, shprehën shqetësim lidhur me mundësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje të shtetasve të këtyre komunave për shkak të largësisë së [QV](#)-ve ku ishin transferuar. Ata sugjeruan që Kodi Zgjedhor duhet të jetë më fleksibël lidhur me numrin minimal të zgjedhësve, që kushtëzon krijimin e [QV](#)-ve, veçanërisht për zonat rurale të malësive, ku shpesh qendrat e banuara janë shumë larg nga njëra tjetra dhe spostimi në një [QV](#) tjetër i detyron zgjedhësit të konsumojnë shumë kohë për të votuar.

Pavarësisht sa më sipër, ne u informuam se në ndonjë rast pushteti vendor kishte marrë masa për të siguruar transportimin e zgjedhësve, me mjete transporti të paguara nga komuna, nga fshati i tyre në fshatin tjetër ku ndodhej [QV](#) pranë të cilës do të votonin. Kjo konsiderohej prej tyre si një ndihmë për zgjedhësit e moshuar dhe ata me problem shëndetësorë, me qëllim që të ushtronin të drejtën e votës, por nga ana tjetër kjo mund të konsiderohet dhe si një rrethanë që mundëson kushte për presion ndaj zgjedhësve, në kushtet kur drejtuesit e pushtetit vendor janë figura politike. KSHH vërejti, gjithashtu se, në këto raste, janë zbatuar praktika të ndryshme në ngritjen e qendrave të votimit. Kështu, në qarkun e Kukësit dhe të Gjirokastrës, u konstatuan raste kur qendra votimi me më pak se 200 zgjedhës nuk ishin shkrirë, por ishte mundësuar transferimi i një numri të vogël zgjedhësish nga ndonjë qendër tjetër në afërsi, me pëlqimin e zgjedhësve, për të plotësuar numrin e 200 zgjedhësve. Në të kundërt kryetari i komunës Pustec na deklaroi se një veprim i tillë nuk i ishte lejuar ta aplikonte për një fshat të komunës së tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.


Sipas nenit 36 të Kodit Zgjedhor [KZAZ](#)-të, brenda datës 3 Qershor, duhet të emëronin anëtarët dhe sekretarët përkatës të Komisioneve të Qendrave të Votimit, por ky proces nuk u krye në kohë¹⁰. Sipas anëtarëve të [KZAZ](#)-ve të kontaktuar arsyeja ishte mosnjohja e ligjit nga partitë politike, që duhej të propozonin në [KQZ](#) kandidatët e tyre dhe neglizhenca e tyre për të respektuar afatet e parashikuara në ligj për këtë proces. Në [KZAZ](#) 35 aluduan se partitë politike mbanin të panjohura emrat e

⁹ Neni 62, pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon se “... Si rregull, qendra e re e votimit nuk është më larg se 5 km nga qendra e votimit që shkrirhet për zonat rurale. Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e mësipërme, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi. Numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret dhe procedurat për bashkimin e qendrave të votimit, në përputhje me këtë pikë.”

¹⁰ Nga monitorimi i kryer nga KSHH në datat 3-4 Qershor 2013, rezultoi se në 12 [KZAZ](#)¹⁰ [KQV](#)-të janë ngritur brenda afatit të parashikuar në Kodin Zgjedhor. Në 12 [KZAZ](#)¹⁰ të tjera rezultoi se ato nuk janë ngritur ende. Në [KZAZ](#) 51 rezultoi se ngritja e [KQV](#)-ve është realizuar pjesërisht, ndërkohë që në [KZAZ](#)-në 79 nuk mundëm të marrim informacion nëse janë ngritur apo jo [KQV](#)-të.

komisionarëve, me qëllim evitimin e presioneve të mundshme mbi ta nga subjektet zgjedhore kundërshtare.

E parë nga pikëpamja e barazisë gjinore, ndonëse neni 36 i [KZ](#) e përjashton këtë kriter nga rregulla për krijimin e [KQV](#)-ve, na rezultoi se nga 807 [QV](#) të monitoruara, në 16.98% të tyre nuk kishte asnjë anëtare femër; në 22.06% të tyre kishte 1 anëtare femër; në 33.33% të tyre 2 anëtare femra; 17.84% të tyre kishte 3 anëtare femra; 6.69% të tyre kishte 4 femra; në 2.35% të tyre kishte 5 anëtare femra dhe në 0.74% të tyre kishte 6 anëtare femra. Vetëm në 25.56% të [QV](#)-ve të monitoruara kryetarja e [KQV](#)-së ishte femër. Shifrat tregojnë se kuota gjinore për të pasur 30% femra është zbatuar e tejkaluar, në lidhje me anëtarët në administratën zgjedhore dhe është përafëruar në lidhje me kryetarët e [KQV](#), të cilat, sipas ligjit përbëhen nga 5 anëtarë 1 kryetar dhe një sekretar. Kjo tregon se komisioni parlamentar, që hartoi amendimet e [KZ](#) dhe Kuvendi që i miratoi ato, manifestuan një konservatorizëm më të madh se strukturat bazë të partive politike që propozuan anëtarët e kryetarët e [KQV](#)-ve.




- QENDRAT E VOTIMIT NË INSTITUCIONET E VECANTA

KShH ka pasur në fokus të monitorimit edhe ngritjen e qendrave të votimit në spitalet rajonale, të cilat sipas nenit 2, pika 2 të Kodit Zgjedhor përbëjnë institucione të posaçme. Nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të Spitaleve Rajonale në Qytetin e Durrësit, Kukësit, Shkodrës, Elbasanit, Fierit, Korçës, Vlorës dhe Gjirokastrës na rezultoi se asnjë prej këtyre institucioneve shëndetësore nuk planifikonte ngritjen e [QV](#)-ve për të mundur ushtrimin e të drejtës së votës nga zgjedhësit e sëmurë, që do të qëndronin në spital për më shumë se tre ditë, përfshi dhe ditën e votimit. Në disa prej spitaleve rajonale u informuam se numri mesatar i pacientëve që qëndronin mbi tre ditë në spital ishte në vazhdimësi mbi 15. Ndonëse këto shifra përputhen me kriteret e përcaktuara nga neni 62, pika 2 e [KZ](#) dhe me udhëzimin e [KQZ](#) për ngritjen e [QV](#) në institucione të posaçme, [KZAZ](#)-të përkatëse nuk i kërkuan [KQZ](#)-së, që sipas nenit 43 të [KZ](#) të krijonte [KQV](#) e posaçme pranë këtyre institucioneve. Nga ana tjetër, përtej indiferentizmit të [KZAZ](#)-ve dhe [KQZ](#)-së, duket se [KZ](#) ka një boshllëk legjislativ, sepse nuk parashikon sesi do të veprohet me transferimin e emrave të zgjedhësve, të cilët sëmuren e shtrohen në spitale pas publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve. I njëjti problem vlen edhe për zgjedhësit që ndodhen në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe të paraburgimit, por siç e kemi shpjeguar në këtë raport, këto institucione e zgjidhën problemin duke i kërkuar gjykatave mundësimin e votimit pranë [QV](#) të ngritura në këto institucione për zgjedhësit e që kishin filluar vuajtjen e dënimit, ose kishin marrë masë sigurie me arrest, pas publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve. Gjithsesi, për të mundur ushtrimin e të drejtës së votës nga zgjedhësit e shtruar në spital, drejtuesit e këtyre institucioneve na informuan se, ditën e votimit, pacientëve do t'u jepej leje për të shkuar të votonin në [QV](#) e tyre, sipas vendbanimit. KShH është e mendimit se kjo praktikë nuk siguron mundësimin për të votuar për të gjithë shtetasit e sëmurë, të cilët ndodhen për kurim në institucionet shëndetësore, veçanërisht të asaj kategorie, që për shkak të gjendjes shëndetësore nuk mund të lëvizë, ose të atyre të sëmurëve që e kanë vendbanimin shumë larg qendrës spitalore. Lidhur me këtë problematikë, vërejmë se [KZ](#) ka mangësi, pasi nuk parashikon dispozita të posaçme për rregullimin e procedurave të hartimit

të listës së zgjedhësve në institucione të posaçme si spitalet, andaj në të ardhmen ligji duhet të përmirësohet edhe në këtë drejtim.

- KRIJIMI I KUSHTEVE PËR AKSES NË QENDRAT E VOTIMIT PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në fokus të monitorimit parazgjedhor ka qenë edhe përshtatshmëria e objekteve të qendrave të votimit për të mundësuar aksesin e duhur personave me aftësi të kufizuara ditën e zgjedhjeve¹¹. Nga monitorimi i kryer, vëzhguesit e KShH dhe vëzhguesit e [FSHDPAK](#) në veçanti, konstatuan se në lidhje me vendosjen e përshtatshme të qendrave të votimit, për kategorinë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara, rezultoi se 80.9%, ose 313 QV ishin të vendosura në katet e para (përdhese) të ndërtesave; 17.5 %, ose 68 QV ishin vendosur në katet e dyta dhe 1.6% në katet e treta.



Për të dhënat e këtij grafiku sqarojmë se numrin më të madh të qendrave të vendosura në katet e para e kishte Tirana, që kishte 56.2% të qendrave të vëzhguara. Ky qark kishte dhe përqindjen më të lartë të qendrave të vendosura në katet e dyta, me 72.1 % të rasteve, ndërkohë që u konstatua se 6 qendra votimi të Tiranës, ishin të vendosura në katet e treta të godinave. Ndërsa Qarku i Shkodrës rezultoi të kishte 45.9 % të qendrave të votimit me hyrje të përshtatura. Në disa [KZAZ](#) të tjera na rezultoi se kishin marrë masat që personat me aftësi të kufizuara të votonin në qendrat e votimit që ndodheshin në katet e para të ndërtesave, duke i spostuar për këtë qëllim në listën e zgjedhësve, si në Qarkun e Kukësit, të Durrësit, etj. Kjo ishte bërë e mundur, sipas një udhëzimi të [KQZ](#) për të identifikuar, paraprakisht, të gjithë personat me aftësi të kufizuara, që banonin brenda juridiksionit të njërive të pushtetit vendor përkatës. Megjithatë vetëm 15.5% e zgjedhësve me aftësi të kufizuara kishin arritur të identifikoheshin paraprakisht nga njësitë e pushtetit vendor, që i kishin ata në listat e votimit. Përfundimisht mund të themi se edhe në këto zgjedhje numri qendrave të votimit, që ishin caktuar në objekte me hyrje të pa përshtatura për zgjedhësit me aftësi të kufizuara ishte shumë i lartë. Ky numër arrinte në shifrën 62.3%, ose 241 QV, nga 387 QV të monitoruara gjithsej.

Jemi të mendimit se legjislacioni zgjedhor duhet përmirësuar e saktësuar më tej në lidhje me garantimin e ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Ky legjislacion duhet përshtatur edhe me konventën e OKB, që trajton të drejtat e këtyre personave, të cilën Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar së fundmi.

¹¹ Sipas Kodit Zgjedhor, brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar sipas kësaj procedure, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.

- FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore, ndonëse jo zyrtarisht, ka filluar 5-6 muaj më parë se afati i caktuar në ligj. Ajo ka qenë e shoqëruar edhe me probleme. Gjatë periudhës parazgjedhore kriminaliteti pësoi rritje, rendi dhe qetësia publike gjatë fushatës zgjedhore nuk ishte në nivelin e duhur, ndërkohë që pati dhe incidente midis militantëve, aktivistëve, përfaqësuesve të organeve të pushtetit vendor, kandidatëve ose drejtuesve të partive, pjesëmarrëse në konkurrim si subjekte zgjedhorë. Respektimi i ligjit dhe standardeve të shtetit të së drejtës pësuan rënie të dukshme gjatë periudhës parazgjedhore.

Në prag të zhvillimit të zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013 në vend u vërejt një angazhim i madh i forcave politike. Ato përgatitën dhe zbatuan programe të detajuara propagandistike, të cilat kishin për qëllim të prezantonin programet e partive për zhvillimin e vendit dhe sukseset që kishin realizuar ato ndër vite. Një pjesë e fushatës ishte ndërtuar mbi bazë të elementëve denigrues ndaj kundërshtarit politik, pa përjashtuar këtu dhe fyerje banale që liderët e partive u adresuan, gjatë mitingjeve ose bisedave në media, kolegëve kundërshtarë. Kjo sjellje indinjoi një pjesë të mirë të popullsisë e cila u shpreh për këtë qëllim si përpara medieve ashtu edhe në takime me monitoruesit tanë.

Sipas informacioneve që kanë ofruar mediet, por edhe nga informacioni që KSHH ka marrë nga shtetas të ndryshëm, rezulton se administrata zgjedhore dhe institucionet arsimore, përfshi dhe nxënësit e mitur, janë përfshirë në aktivitete të fushatës, që u zhvilluan brenda orarit zyrtar, ose gjatë kohës së mësimi, veçanërisht në rastin e inaugurimeve të objekteve të ndryshme të infrastrukturës. Investimet publike janë shfrytëzuar për fushatë zgjedhore nga ana e partive të koalicionit të shumicës parlamentare.

Neni 88 i Kodit Zgjedhor ndalon përdorimin e burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Mendojmë se subjektet zgjedhore, sidomos shumica qeverisëse, duhet të mbante më mirë parasysh faktin se OSBE/ODHIR vazhdimisht ka artikulluar kritika për shfrytëzimin e inaugurimeve për qëllime elektorale, gjë që bie ndesh edhe me paragrafin 5 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990. Gjithashtu ka pasur të dhëna për ushtrim presioni ndaj punonjësve të administratës shtetërore për të dalë në mitingje ose për të votuar në favor të partive të shumicës. Sjellje të tilla cenojnë lirinë e votës, cenojnë standardin e zgjedhjeve, por janë edhe të dënueshme penalisht.

KShH është informuar gjatë takimeve sensibilizuese, të zhvilluara me minoritetin Rom të lokalizuar në rrethin e Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Fierit, Korçës dhe Gjirokastrës, se ky minoritet ka qenë viktimë e praktikave abuzive dhe korruptive, të ndjekura nga forca të ndryshme politike, që kanë për qëllim blerjen e votave të tyre.

Standardet e Kopenhagenit dhe legjislacioni vendas përcaktojnë se propaganda zgjedhore duhet të jetë jo vetëm e ligjshme, por dhe e tillë që të mos cenojë të drejtat e njeriut dhe gjithmonë në shërbim të informimit të drejtë dhe të saktë të zgjedhësve. KShH konstatoi me keqardhje se fushata zgjedhore u shoqërua me tone agresiviteti dhe se incidentet nuk munguan. Gjuha e urrejtjes është një karakteristikë tjetër e kësaj fushate. Te gjitha këto influencuan negativisht në atmosferën që rrethoi zgjedhësit në momentin që duhej të formonin bindjen e tyre në lidhje me ushtrimin e të drejtës së votës.

- **SITUATA E RENDIT DHE QETËSISË PUBLIKE NË PERUDHËN PARAZGJEDHORE**

Nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të Drejtorisë së Policisë në Qarqe, KShH u informua se efektivat e policisë marrën udhëzimet përkatëse, në prag të zgjedhjeve të 23 Qershorit, lidhur me rolin e policisë në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, në kuadër të këtij procesi zgjedhor. Ata kishin hartuar plane konkrete, në përshtatje me situatën e qarqeve ku do të vepronin dhe kishin trajnuar gjithë stafet e policisë për këtë qëllim. Megjithatë situata e kriminalitetit në periudhën parazgjedhore, siç e kemi përmendur dhe më lart, rezultoi në rritje. Gjatë periudhës parazgjedhore, por edhe ditën e zgjedhjeve kanë ndodhur ngjarje të rënd, që kanë përfshirë, në disa raste dhe subjektet zgjedhore, ose kandidatët e tyre për deputetë. Bazuar në këto fakte publike KShH mendon se organet e policisë duhet të kishin punuar më shumë në drejtim të parandalimit të këtyre ngjarjeve, si dhe për të rritur forcën zbuluese dhe goditëse të krimit, me qëllim që të garantohet një situatë e qetë dhe e sigurt për zgjedhësit dhe mbarë shtetasit.

III. PROCESI I VOTIMIT

Nga raportet e monitorimit të ditës së votimit dhe raportet e monitorimit të pjesshëm të procesit të numërimit të votave rezulton si vijon:

- PËRGATITJET PËR PROCESIN E VOTIMIT

Standardet e Kopenhagenit përcaktojnë se lidhur me organet e administrimit zgjedhor dhe procedurat zgjedhore shtetet palë duhet të garantojnë procedura zgjedhore korrekte, që mundësojnë respektimin e zgjedhjeve të lira, të drejta e të fshehta.

A. Trajnimi i anëtarëve të Komisioneve të Qëndrave të Votimit (KQV)

Zëvendësimet e anëtarëve të [KQV](#)-ve, me kërkesë të partive politike përkatëse kanë vazhduar deri në ditën e zgjedhjeve. Megjithatë shumica e anëtarëve të [KQV](#)-ve u trajnuan rregullisht nga [KQZ](#)-ja, me përjashtim të anëtarëve që u përfshinë në proces disa ditë para zgjedhjeve, ose ditën e votimit. Trajnime të anëtarëve të [KQV](#)-ve sipas përkatësisë politike të komisionerëve, zhvilluan edhe partitë politike përkatëse, që ishin njëkohësisht subjekte zgjedhore. Megjithatë u konstatua se, në disa raste, anëtarët e [KQV](#) nuk kishin njohuritë e duhura për t'u dhënë zgjidhje ligjore problemeve që hasnin gjatë procesit të votimit dhe nuk kanë munguar rastet kur ata kërkonin ndihmë nga vëzhguesit e akredituar, që ndodheshin në [QV](#) për të vëzhguar.

B. Mjediset ku u vendosen QV-të dhe ndihma për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.


Nga monitorimi rezultoi se në shumicën e [QV](#)-ve ambientet fizike ishin normale, në përputhje me nevojat e ushtrimit të veprimtarisë së votimit, me hapësira të bollshme dhe vendosja e pajisjeve ishte bërë sipas skemës së miratuar nga [KQZ](#). Megjithatë, në disa [QV](#) u vu re se pajisjet ishin vendosur në mënyrë të papërshtatshme, ose kishte raste kur hapësirat e ambienteve ishin të vogla, si në [QV](#)-të nr 2013/1, 2013/3, 1911/1 etj. Për pasojë në këto [QV](#) u krijua konfuzion gjatë votimit. Në ndonjë rast kjo ndikoi edhe në drejtim të cenimit të fshehtësisë së votës, sepse komisionarët e [QV](#)-së, për shkak të mungesës së hapësirës, ishin vendosur shumë pranë dhomës së fshehtë të votimit dhe mund ta mbikëqyrnin atë. Mjedisi i kufizuar në ndonjë rast u bë pengesë që vëzhguesit, vendas dhe të huaj të kryenin mirë detyrën e tyre, si p.sh [QV](#) 2013/1, 2013/3, 1911/1.

Kushtet fizike të [QV](#)-ve janë të lidhura drejtpërdrejt me mundësitë reale për ushtrimin e të drejtës së votës nga zgjedhës me aftësi të kufizuara. Më sipër kemi trajtuar situatën e përshtatshmërisë së mjediseve ku janë vendosur [QV](#) për t'u mundësuar akses zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Kjo situatë tregon se edhe në këto zgjedhje ka pasur indiferentizëm të organeve përkatëse në këtë drejtim. Shifrat tregojnë se njësitë e pushtetit vendor nuk kanë ndjeshmërinë e duhur për t'i caktuar qendrat e votimit

në objekte të përshtatshme për këtë kategori zgjedhësish dhe se [KOZ](#), si organi më i lartë përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve, nuk e ka mbikëqyrur mirë këtë situatë.

Shtetasit me aftësi të kufizuara e gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur. Kjo sanksionohet qartazi nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Zgjedhor, në Konventën e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe në Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kodit Zgjedhor ka pësuar përmirësime në vazhdimësi për këtë drejtim¹². Me gjithë këto përmirësime, e drejta zgjedhore për zgjedhësit me aftësi kufizuara mbetet ende e cenuar, sepse edhe në rastet kur janë marrë masat për përshtatshmërinë e hyrjes në [QV](#), faktikisht është lehtësuar vetëm mundësia e këtyre zgjedhësve për të hyrë në qendrën përkatëse të votimit, por jo për të votuar. Ka ende nevojë për përmirësime ligjore me qëllim që personave me aftësi të kufizuara t'u jepet ndihma e nevojshme për të shkuar nga banesa tek [QV](#)-ja përkatëse, sepse ata për shkak të aftësisë së kufizuar nuk mund të përshkojnë distancën nga banesa tek [QV](#) përkatëse pa masa ndihmëse.

Vlen të përmendet fakti se vetëm në 60 [QV](#), ose 15.5% e të gjitha qendrave të vëzhguara, pushteti vendor kishte identifikuar më parë zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që ishin votues në listat përkatëse të zgjedhësve, siç kërkohet nga ligji dhe udhëzimi i [KQZ](#). Ndër to Tirana dhe Durrësi kishin përqindjen më të ulët të [QV](#)-ve ku zgjedhësit me aftësi të kufizuara ishin identifikuar paraprakisht në lista, respektivisht me 26.7 % dhe 3.3 % të totalit të monitoruar, kundrejt 40% në Shkodër dhe 30 % në Elbasan. (shih tabelën me poshtë) Identifikimi paraprak i kësaj kategorie të zgjedhësve është një e dhënë që ndihmon në marrjen e masave të përshtatshme në favor të tyre, përpara ditës së votimit



C. Dorëzimi i materialeve zgjedhore

Nga një monitorim paraprak që KSHH realizoi në datën 22 qershor 2013, në 35 [KZAZ](#)¹³, të vendosura në 9 qarqet e vendit ku u shtri monitorimi, vumë re që materialet zgjedhore nuk u dërguan brenda afatit ligjor, nga [KZAZ](#)-të në [KQV](#)-të përkatëse. Sipas Kodit Zgjedhor, dërgimi dhe marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore duhet të kryej jo me vonë se 15 orë para hapjes së votimit (pra jo me vonë se ora 16:00 e datës 22 Qershor). Madje në Fier, në [KZAZ](#) nr. 60, konstatuam se procesi i dërgimit të materialeve zgjedhore në [QV](#)-të përkatëse ishte pezulluar, pasi të dyja forcat kryesore politike kishin kërkuar që më parë të bëhej ndërrimi i përbërjes së komisioneve të qendrave të votimit. Vonesat u konstatuan përkatësisht [KZAZ](#)-të nr. 23, 31, 32, 33, 34, 36, 37, 38, 48, 49, 50, 51, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86. Nuk kanë munguar dhe rastet kur materiali i mbritur pranë [KQV](#)-ve kishte pasaktësi ose mungesa, ngatërresa të kapakëve të kutive, të materialeve të votimit dhe fletëve të votimit, ose probleme të tjera me kodet e sigurisë. Këto probleme janë konstatuar në Korçë [QV](#) 3660, në Tiranë

¹² Nga viti 2002 e në vijim legjislacioni zgjedhor ndryshoi cilësisht mundësinë e votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, duke kaluar nga mënyra e votimit vetëm nëpërmjet shoqëruesit (KZ- 2002), në alternativën që parashikonte dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në votime për zgjedhësit me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim, duke krijuar lehtësirat në mjete dhe shërbime (Kodit Zgjedhor 2003).

¹³ 55 % [KZAZ](#)-ve të monitoruara

[QV](#) 1493, 1416, 1711/1, 1947/2, 1948, 1890 etj, por fatmirësisht ato u zgjidhën në kohë, sipas ligjit, nga [KZAZ](#)-të ose [KQZ](#)-ja, gjatë ditës së votimit dhe nuk u bënë shkak për të penguar zhvillimin e procesit të votimit. Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se na rezultoi, gjithashtu, se rreth 79%, ose 305 [QV](#) nuk ishin pajisur nga [KQZ](#)-ja me dhomë fshehtësie të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara (kryesisht për përdoruesit e karrigeve me rrota), gjë që tregon për masa jo të plota përgatitore, që do t'u mundësonte zgjedhësve me aftësi të kufizuara votim personal e të fshehtë. Në këtë aspekt paraqitej më mirë qyteti i Elbasanit me 48.1% të [QV](#)-ve të pajisura me dhomë të fshehtësisë të përshtatura, kundrejt Tiranës me 16.5% të [QV](#)-ve. [KQZ](#) dështoi të përmbushë detyrimin ligjor për t'u mundësuar personave të verbër të përdornin fletët e votimit të posaçme, siç është parashikuara shprehimisht nga neni 108/6 i [KZ](#).

D. Respektimi i heshtjes zgjedhore

Sipas Kodit Zgjedhor, 24 orë para ditës së votimit duhet të jetë heshtje zgjedhore, por u konstatua se pavarësisht nga kjo, në disa raste, heshtja është thyer. Një ditë përpara votimit, por dhe ditën e votimit zgjedhësve u janë dërguar sms, me anë të të cilave u bëhej thirrje për votim në favor të disa subjekteve zgjedhore. Pranë disa qendrave të votimit në afërsi, rreth 20 deri 150 metra, janë vënë re materiale propagandistike si flamuj¹⁴ e postera, që promovonin subjekte zgjedhore të caktuara, ndërsa brenda [QV](#)-ve u vu re se disa anëtarë të komisionit të [QV](#)-ve mbanin me vete materiale propagandistike si byzylykë, stilolapsa, varëse, ora, bluza me shenja ose simbole të subjekteve zgjedhore. Në 14.63% të [QV](#)-ve të monitoruara u panë të afishuara, brenda distancës së ndaluar me ligj, materiale propagandistike. Këto shkelje u konstatuan në Tiranë [QV](#) 1991, në Novoselë Vlorë [QV](#)4406¹⁵.

E. Ankimi në gjykatë për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës

Gjatë verifikimeve të kryera në Gjykatat e 9 rretheve gjyqësore ku u shti monitorimi ynë, rezultoi se numri i kërkesave të shtetasve drejtuar gjykatave, për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës ishte shumë i ulët. Gjithsej në këto 9 gjykata janë drejtuar 349 kërkesa. Nga ky total 240 kërkesa me objekt mundësimin e ushtrimit të të drejtës së votës i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila pasi i shqyrtoi ato dha 240 vendime gjyqësore, ndër të cilat në 219 raste kërkesa është pranuar, në 8 raste kërkesa është rrëzuar, dhe në 13 raste çështja është pushuar. Nga verifikimi rezultoi se shumica e kërkesave i ishin drejtuar gjykatës nga persona që janë duke vuajtur dënimin me heqje lirie, ose të paraburgosur, që qëndrojnë në [IEVP](#) ose pranë Institucioneve të Paraburgimit. Konkretisht 86 kërkesa i janë adresuar gjykatës nga [IEVP](#) nr. 313 dhe 46 nga [IEVP](#) nr. 302 në Tiranë. Në rrethet e tjera kërkesat drejtuar gjykatave kanë qenë shumë të pakta, konkretisht në Gjykatën e Kukësit 1 kërkesë; në Gjykatën e Fierit 3 kërkesa; në Gjykatën e Shkodrës 10 kërkesa; në Gjykatën e Elbasanit 50 kërkesa, ku mbizotërojnë kërkesat e paraqitura nga IP Elbasan dhe Peqin; në Gjykatën e rrethit Korçë 27 kërkesa, të gjitha nga [IEVP](#) Korçë; dhe në Gjykatën e Vlorës 19 kërkesa, të gjitha nga IP Vlorë. Gjykatat kanë respektuar afatet ligjore për pranimin e kërkesave dhe për shqyrtimin e tyre, si dhe kanë dhënë vendime të arsyetuara, të cilat janë pranuar nga [KQV](#), duke u dhënë mundësinë shtetasve përkatës të ushtrojnë të drejtën e votës, kur gjykata ka urdhëruan një gjë të tillë me vendimin përkatës.

- ECURIA E PROCESIT TË VOTIMIT

Lidhur me zhvillimin e procesit të votimit standardet demokratike të Kopenhagenit përcaktojnë se zgjedhjet duhet të jenë të lira, të ndershme, dhe të garantojnë votim të lirë e të fshehtë. Procesi ligjor duhet të garantojë votimin e përgjithshëm dhe në kushte të barabarta për shtetasit madhorë, gjithashtu votat duhet të numërohen dhe raportohen me ndershmëri dhe rezultatet e tyre zyrtare duhet të bëhen publike pa vonesa të papërligjura.


¹⁴ Ne Tirane Qv 1944/3, Shkodër QV 0217,

¹⁵ Është bërë vërejtje me shkrim nga vëzhguesja jonë

A. Pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Pjesëmarrje e zgjedhësve në këtë proces votimi shënoi rritje. Sipas deklaramit të [KQZ](#) morën pjesë në zgjedhje mbi 53,50% e votuesve¹⁶. Përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes në votim e shënoi qarku i Lezhës me 57,93% të votuesve, i pasuar nga qarku i Fierit me 55,83% të votuesve, ndërsa përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes në zgjedhje e pati qarku i Vlorës me 39,33% të votuesve. Në këta tregues e shifra duhet të mbajmë parasysh faktin së vendi ynë ka emigracion të madh të popullatës, jashtë kufijve të vendit, të cilët janë të përfshirë në listën e zgjedhësve por kanë pak mundësi për të marrë pjesë efektivisht në zgjedhje, në kushtet kur nuk ekzistojnë mundësi të tjera për të ushtruar të drejtën e votës, përveçse duke u paraqitur personalisht në qendrën përkatëse të votimit.

Duke iu referuar statistikave të marra nga INSTAT janë afërsisht 134 mijë persona me aftësi të kufizuara në moshë votimi, që do të thotë rreth 97 % e totalit të tyre ose 6.05% e popullsisë së vendit. Gjatë procesit të monitorimit, në 387 qendrat e vëzhguara, u evidentuan se morën pjesë në votim, në total, 1403 persona me aftësi të kufizuara, prej të cilëve në Tiranë votuan 620 persona, në Durrës 109, në Shkodër 330 dhe në Elbasan 344.



Ndër shtetasit që morën pjesë në votim, 519 ishin me aftësi të kufizuara në lëvizje; 379 me aftësi të kufizuara në shikim; 262 me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe 243 me aftësi të kufizuara intelektuale. Personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë se pjesëmarrja e tyre në proceset zgjedhore është një mënyrë që ndikon në përsheptimin e integritit të tyre, ku nëpërmjet mekanizmit të votës, ndikojnë tek politikëbërësit në hartimin e politikave dhe ligjeve që realisht luajnë rol në përmirësimin e cilësisë së jetesës për ta dhe familjarët e tyre.

B. Zhvillimi i votimit


Procesi i votimit ka filluar me vonesë pothuajse në 70% të qendrave të votimit të monitoruara, vonesa që kanë shkuar edhe në mbi 1 orë. Këto vonesa janë shkaktuar më së shumti nga mungesa e komisionarëve (kryesisht atyre të PR dhe LSI), ose nga mbritja e tyre me vonesë në selinë e [QV](#) përkatëse, si dhe për shkak të kryerjes me vonesë të procedurave të hapjes së votimit. Në 83.93% të [QV](#) të monitoruara anëtarët kanë qenë prezent në [QV](#)-në përkatëse në orën 6:00, sipas ligjit dhe vetëm në 16.07% e tyre kanë ardhur pas këtij afati kohor. Vonesat janë shkaktuar në disa raste dhe për shkak të parregullsive në [QV](#). Në 2.42% të [QV](#)-ve të monitoruara gjendja e [QV](#) nuk ishte e rregullt në kohën kur duhet të fillonte votimi dhe për pasojë përgatitja e qendrës shkaktoi vonesë. Vonesat janë

¹⁶ Kjo e dhënë është marrë nga faqja zyrtare e KQZ më 31 Korrik 2013

konstatuar më shpesh në qarqet Tiranë¹⁷ Gjirokastër¹⁸, Kukës¹⁹ Vlorë²⁰ Shkodër. Votimi ka filluar me vonesë me më shumë se 1 orë në disa qendra votimi të qarkut Vlorë, si në komunën Armen, në komunën Novoselë [QV](#)-të nr 4398, 4406, 4454, 4504/1; në qarkun Gjirokastër [QV](#) nr. 4235; në qarkun Elbasan [QV](#) nr 2339, 2708, etj

Gjatë ditës së votimit fluksi i zgjedhësve që paraqiteshin për të votuar nuk ka qenë problematik, kjo edhe për shkak të zvogëlimit të numrit të zgjedhësve që do të votonin në një [QV](#). Vetëm në 40.20% të [QV](#)-ve të monitoruara ka pasur radhë votuesish në momente të caktuara të ditës.

Nuk u konstatuan probleme të mëdha, ose parregullsi serioze lidhur me listat e votimit por pati vështirësi, veçanërisht në Tiranë, për gjetjen e [QV](#) ku do të votohej, për shkak se ato ishin ndarë me fraksione dhe nuk ishin vendosur shenja orientuese, të mjaftueshme, për të orientuar qartë zgjedhësit. Megjithatë në raste sporadike rezultoi se disa persona nuk e gjetën emrin në lista dhe për këtë arsye nuk u lejuan të votonin. Në 962 [QV](#)-të e monitoruara pati pak votues që iu mohua e drejta e votës. Nga këta 156 zgjedhës, që ne konstatuam se nuk u lejuan të votojnë, rezultoi se pengesat kishin qenë të natyrave si vijon: në 16.67% ose 26 persona nuk mundën të votonin për arsye se kishin pasaktësi në regjistrimin e emrit në listën e zgjedhësve; në 14.74%, ose 23 persona nuk mundën të votonin për arsye se kishin mjet identifikimi të pavlefshëm; në 6.41%, ose 10 persona nuk mundën të votonin sepse nuk përputhej mbiemri i votuesit në listën e zgjedhësve nga ai i shënuar në dokumentin e tij të identifikimit; në 51.28%, ose 80 persona nuk u lejuan të votonin pasi nuk e kishin emrin në listën e zgjedhësve.



C. Votimi Familjar

Edhe në këtë zgjedhje është konstatuar një përhapje më e gjerë e votimit familjar, në raport me zgjedhjet e kaluara. Konkretisht ky fenomen u has në Vlorë²¹, në Tiranë²², Korçë²³, Shkodër (Koplik), në Gjirokastër, etj duke u shfaqur edhe në qarqe ku më parë nuk ishte evidentuar. Monitoruesit tanë kanë bërë vërejtje të shumta me shkrim në këtë drejtim, por komisionerët rrallë kanë reaguar. Nga kjo

¹⁷ QV1489/2, 1392/1, 1492, 1439, 1799/1, 1910, 1869/2, 1490, 1895/2, 1906, 1425, 1789, 1730/2, 1703/2, 1888/3, 2003, 1853, 1481/1, 1683/1, 1684, 1748, 1992, 1493/1, 1528, 1991/1, 1925/1, 2984/1, 3005/1, 30231, 2995/1, 2994/1, 1489/2, 1910, 1885, 1835, 1890, 1425, 1789, 1392/1, 1703/2, 188/3, 1804/2, 1410, 1885, 1947/2, 1948,

¹⁸ QV 4252, 4251

¹⁹ ,QV 0652,0651,

²⁰ QV4499, 4499/1, 4500, 45001, 4504, 4428, 44281, 4454, 4473, 4419, 4419/1, 4420,

²¹ QV 45041, 4398

²² QV 1703/1, 1983/1, 1876/1, 1703, 1876, 4504, 2376, 2041/1, 2041/2, 2042/3

²³ QV 3647, 3647, 3664/1, 3700/1, 3673, 3658, 3678

rezulton se në të ardhmen duhet punuar më mirë për trajnimin e tyre në këtë aspekt dhe duhet rritur nxjerrja e përgjegjësive ndaj lejimit të këtij fenomeni. Në qarkun e Tiranës ka pasur raste kur votimi është ndërprerë për shkak të rasteve të shumta të votimit familjar, ndërsa në qarkun Gjirokastrë është konstatuar se votimi familjar është aplikuar në [QV](#)-të ku votonte minoriteti rom, me justifikimin se zgjedhësit nuk dinin të lexonin. Në 16.48% të [QV](#)-ve të monitoruara, ose 146 [QV](#), ka pasur votim familjar, në 14.11% të [QV](#)-ve të monitoruara ky fenomen ka ndodhur rallë, ndërsa në 2.14% të [QV](#)-ve të monitoruara kjo gjë ka ndodhur shpesh.

D. Respektimi i procedurave të veçanta për zgjedhësit me aftësi

Lidhur me votimin e personave me aftësi të kufizuara, në shumë raste, nuk janë respektuar procedurat e parashikuara në nenin 108 të Kodi Zgjedhor. Në këtë drejtim janë vërejtur një sërë problematikash si: mosdeklarimi në librin e protokolleve të personave që kanë ndihmuar votuesit me aftësi të kufizuara; raste të ndihmës së dhënë nga komisionarët në dhomën e fshehtë; ndërsa në ndonjë rast, si në [QV](#) 1994/3, nuk janë lejuar personat me aftësi të kufizuara të ndihmohen nga persona të tjerë, siç parashikon ligji. Një rast flagrant shënohet në [QV](#) 1869/1 ku një person me aftësi të kufizuara mendore është ndihmuar nga një zgjedhës tjetër, i cili ka votuar pa e pyetur votuesin. Shkelje në këtë drejtim janë vërejtur edhe në Korçë, Tiranë, Elbasan etj. Gjithashtu u konstatua se 86 % e personave me probleme dëgjimi nuk patën ndërmjetësimin e interpretit të gjuhës së shenjave, që do të jepte mundësinë e informacionit plotësues gjatë votimit, gjë që u krijoi atyre pasiguri lidhur me shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të tyre gjatë votimit.

[KQZ](#) miratoi Vendimin Nr. 9, date 10.01.2013, ku përcaktohet standardi për dhomat e fshehtësisë, të cilat duhet të ishin të posaçme për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë në 78.8%, ose në 305 [QV](#), nga 387 të vëzhguara, u vërejt mungesa e përshtatjes së dhomave të fshehtësisë për zgjedhësit përdorues të karrigeve me rrota. Qyteti i Elbasanit paraqitej më mirë në këtë drejtim me 48.1% të qendrave të votimit të pajisura me dhomë të fshehtësisë të përshtatura, kundrejt Tiranës me 16.5%. Mungesa e këtyre dhomave të posaçme në qendrat e votimit tregoi për mungesën e vëmendjeje dhe mosmarrjen e masave konkrete për të zbatuar vendimin e mësipërm të [KQZ](#). Lidhur me zgjedhësit e verbër, ndonëse Kryetarja e [KQZ](#) kishte deklaruar publikisht se do të merreshin të gjitha masat për prodhimin e fletëve të votimit të përshtatura për këtë kategori, ashtu siç sanksionon neni 108/6 [KZ](#), faktikisht ky premtim dhe urdhërimi ligjor nuk u bënë realitet.

Në lidhje me mënyrën e votimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara rezultoi se 65.1 % e zgjedhësve me aftësi fizike, 14.2 % e zgjedhësve me probleme të shikimit; 75.7 % e zgjedhësve me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 86% e zgjedhësve me aftësi në dëgjim votuan vetë, pa asistencë nga persona të tjerë. Nga zgjedhësit me probleme dëgjimi, që votonin në qendrat e monitoruara, vetëm 14% e tyre votuan me praninë e interpretit të gjuhës së shenjave, duke bërë që pjesa tjetër të mos ishte e sigurt në vlefshmërinë e votës që tyre, për shkak se nuk morën udhëzime për mënyrën e votimit. Asistenca për zgjedhësit me aftësi u ofrua, në masë më të madhe, në qarkun e Shkodrës, në 56.8 % të rasteve, ndërsa me shumë asistencë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara në shikim u ofrua në Durrës në masën 90.0% të rasteve.

Përsa i përket qëndrimit të mbajtur nga komisionerët ndaj zgjedhësve me aftësi të kufizuara rezultoi se në 387 [QV](#) të vëzhguara në rajonet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Elbasanit ata mbajtën qëndrim pozitiv ndaj votuesve me aftësi të kufizuara. Më konkretisht qëndrimi i komisionerëve është vlerësuar normal në 48.6% të rasteve dhe mikpritës në 37.0% të rasteve. Më e spikatur kjo sjellje në Tiranë dhe Durrës, ku u në të gjitha rastet është manifestuar qëndrim normal dhe pozitiv ndaj zgjedhësve me aftësi


të kufizuara, ndërsa në Elbasan dhe në Shkodër kishte, në përqindje të ulët, edhe qëndrime fyese e indiferente, përkatësisht në 3.8 % dhe 2.7 % të rasteve.

E. Qetësia dhe rregullshmëria e procesit të votimit dhe roli i policisë.

Në shumicën e QV-ve votimi ka vijuar i qetë dhe pa flukse të mëdha të personave që prisnin të votojnë. Megjithatë në këto zgjedhje ndodhën edhe disa incidente të rënda, në afërsi të QV-ve, ose brenda tyre, si rasti i vrasjes së simpatizantit të LSI dhe plagosjes së kandidatit të PD-së në Laç, goditja e komisionarit të PS në Kamëz; plagosja e tre simpatizantëve të Partisë socialiste në Laprakë të Tiranës, etj. Gjithashtu në mjediset jashtë QV është konstatuar një fluks i madh i personave që kryenin detyra në emër të subjekteve politike, të cilët kanë shkaktuar rëndim të qarkullimit dhe kanë tensionuar atmosferën pranë QV dhe në ndonjë rast u kanë bërë presion zgjedhësve që të votojnë për partinë të cilës i shërbente militanti. Presion mbi zgjedhësit është vënë re dhe nga kandidatët për deputet të PD-së në QV nr. nr. 3673 të Korçës, si dhe nga kryetari i Bashkisë Kamëz në QV nr. 1573, etj. Megjithatë presioni mbi zgjedhësit nuk rezultoi si fenomen shqetësues.

F. Ushtrim presioni në brendësi të QV-ve

Nuk kanë munguar dhe raste të presionit mbi zgjedhësit, komisionerët, mediet dhe monitoruesit. Në ndonjë rast vëzhgues të subjekteve zgjedhore kanë orientuar zgjedhësit lidhur me procedurat që duhej të kryeshin nga zgjedhësit për të kryer votimin; në ndonjë rast tjetër ata kanë ndërhyrë duke u treguar zgjedhësve si të palosin fletën e votimit, ose si ta plotësojnë atë²⁴ Është vënë re gjithashtu se disa vëzhgues të subjekteve zgjedhore si dhe militantë të subjekteve zgjedhore kanë ushtruar presion mbi zgjedhësit e pranishëm brenda QV-ve, si p.sh. në QV 1803/1, 1960/2, 2041/1, 4497/2. Megjithatë rastet kanë qenë sporadike dhe në mënyrë statistikore rezultoi se vetëm në 0.56% të rasteve është ushtruar presion ndaj zgjedhësve dhe në 1.01% të rasteve është ushtruar presion ndaj anëtarëve të KQV-së. Nuk kanë munguar dhe raste sporadike ku ka pasur fluks votuesish dhe konfuzion brenda qendrës së votimit, ose dhe raste konfliktesh, si në Elbasan²⁵, Tiranë²⁶ në Vlorë (4504, 45041), Burgu 302, në Gjirokastrë (4265)etj. Tensionet brenda QV-ve ka rezultuar se janë shkaktuar sipas shkaqeve të shënuara në tabelën vijuese.



²⁴ Rasti ka ndodhur në QV 1711/1.

²⁵ QV 356, 2356/1, 2357, 2335/1, 2339/1, 2339, 2327, 2305, 2306

²⁶ QV 1982/2, 1803, 1757/1, 1853, 18291, 1682/1, 1682/2, 1854/2.

G. Funksionimi i [KQV-së](#).

Në pjesën më të madhe të [QV](#)-ve që kemi monitoruar, funksionimi i komisioneve përkatëse ka qenë i qetë dhe në përputhje me ligjin. Rezultatet e vëzhgimit treguan për një ndërgjegjësim të lartë të komisioneve zgjedhore për të mirëpritur e orientuar zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Megjithatë janë vënë re disa problematika. P.sh. në 9.43% të rasteve në [QV](#) e monitoruara Komisioni nuk u morr vendimi për hapjen e votimit, siç përcakton ligji, ose në 1.29% të [QV](#) të monitoruara anëtarët e komisionit nuk e verifikonin në të gjitha rastet përputhshmërinë e emrit të zgjedhësit në dokument me atë të listës. Megjithatë, përsa i përket radhës së punës për realizimin e votimit nga zgjedhësit, e cila nuk ka pësuar ndryshime nga zgjedhjet e kaluara, rezultoi se pothuaj në të gjitha [QV](#)-të janë respektuar dhe janë kryer siç përshkruhet në ligj. Kështu në [QV](#)-të e monitoruara në 97.20% të rasteve zgjedhësve u është kërkuar të tregojnë dokumentin e identifikimit dhe vetëm në 0.54% të rasteve kjo kërkesë e ligjit është anashkaluar. Përgjithësisht komisionerët kanë bërë verifikime të identitetit të zgjedhësit nëpërmjet dokumentit personal, gjetjen e emrit në listën e zgjedhësve dhe krahasimi i identitetit të tij me atë të shënuar në dokumentet personale, firmosjen në listën e zgjedhësve nga zgjedhësi i paraqitur për votim, verifikimin e timbrosjes dhe më pas timbrosjen e zgjedhësve sipas procedurave ligjore. Përfundimisht, në ndonjë rast sporadik, verifikimi i timbrosjes nuk është bërë rregullisht, si në Shkodër ([QV](#) në Teatrin Migjeni), ose timbrosja bëhej pasi zgjedhësi kishte votuar (Komuna Aliban, Vlorë [QV](#) 4400). Për më tepër verifikoni statistikën e grafikët që i bashkëngjiten këtij raporti.

Janë vënë re dhe raste sporadike të pezullimit të procesit të votimit, të cilat kanë ardhur për shkak të mungesës së bazës materiale, për shkak të gabimeve të bëra nga komisioni gjatë zbatimit të procedurave të votimit, debateve midis anëtarëve të komisionit, ndërprerja në mënyrë të pamotivuar etj, si p.sh. në Korçë [QV](#) 3660, në Tiranë [QV](#)1493/1, 1416, 1928/1, 1839, në Shkodër [QV](#) 295, etj.

4. MBYLLJA E VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE

- PROCEDURAT E MBYLLJES SË VOTIMIT

Në shumicën e qendrave të votimit mbyllja e procesit të votimit është kryer në orën 19:00, normalisht dhe paqesisht, duke respektuar kohën dhe procedurën ligjore. Në disa [QV](#), votimi u mbyll me vonesë, për shkak të radhës së zgjedhësve, që ndodheshin të pranishëm jashtë [QV](#) në orën 19.00, të cilët sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor u lejuan të votonin. Vonesat u përkasin [QV](#) 1977, 2569/1, 1714, 1966, 1418/1, etj.

Transportimi i kutive me materialet zgjedhore është bërë në rregull, e në përputhje me ligjin. Komisionerët shoqëruan bashkërisht materialet, në praninë e një punonjësi të policisë. Pati ndonjë rast kur transportimi i materialeve u bë me vonesë, por nuk ka pasur asnjë pretendim në lidhje me cenimin e kutive me materiale zgjedhore që transportoheshin.

- NUMËRIMI I VOTAVE

A. Krijimi i grupeve të numërimit të votave

KShH monitoroi procesin e numërimit të votave në disa aspekte. Nga monitorimi ka rezultuar se propozimet e partive politike për anëtarët e grupeve të numërimit ([GNV](#)-të) kanë mbritur me vonesë në [KZAZ](#)-të përkatëse dhe për pasojë këto grupe nuk u krijuan në të gjitha rastet brenda afatit të parashikuar në ligj. Mangësi u vërejtën edhe në drejtim të verifikimit të e dokumentacionit që duhet të plotësonin partitë politike për anëtarët e propozuar. Trajnimi zyrtar i [GNV](#)-ve pritej të bëhej në orët e vona të natës, të datës 22 Qershor 2013, por efektivisht, në të gjitha rastet e monitoruara, u krye në datën 23 Qershor, pas përfundimit të procesit të votimit.

B. Respektimi i afatit dhe rregullave ligjore për kryerjen e numërimit.

Procesi i numërimit të votave nuk u realizua brenda afatit 48 orësh të përcaktuar në ligj. Me përjashtim të [KZAZ](#)-ve nr. 21, 81, 82, 84, 85 dhe 86 në pjesën tjetër të [KZAZ](#)-ve numërimi përfundoi pas afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor për nxjerrjen e rezultatit (ora 22:00 të dt. 24 Qershor). Arsyet e vonesave apo mos fillimit të numërimit janë: mos mbërritja në kohë e materialeve zgjedhore nga [QV](#)-të; mos konstituimi në kohë i grupeve të numërimit në disa [KZAZ](#); zhvillimi i trajnimit të grupeve të numërimit në orët e para të mëngjesit; mungesa e organizimit të punës dhe instalimit të pajisjeve në ambientet e numërimit; etj. Në [KZAZ](#)-te 32 dhe 49, në orët e para të mëngjesit të datës 24 Qershor, u morr vendimi për ndërprerjen e numërimit dhe për rifillim e numërimit në orën 10:00 për shkaqe të paqarta. KShH vlerëson se të gjitha këto problematika të konstatuara janë dukuri të evidentuara edhe në zgjedhjet e kaluara, prandaj në të ardhmen i duhet kushtuar kujdes më i madh këtij procesi, duke marrë masa për një përgatitje më të mirë të organeve të administratës zgjedhore në këtë drejtim. Megjithatë mund të themi se në këtë drejtim janë shënuar përmirësime të dukshme, sepse në shumicën e [KZAZ](#)-ve numërimi i votave përfundoi brenda 4-5 ditëve, ndonëse ai në përgjithësi filloi me vonesë. Marrja në dorëzim e kutive të fletëve të votimit dhe materialeve të tjera të votimit është bërë me vonesë, për shkak të zgjatjes së procedurave të këtij procesi. Kjo ka sjellë si pasojë që, në shumicën e [KZAZ](#)-ve të monitoruara, në orët e para të mëngjesit të datës 24 Qershor, kanë qenë të papërgatitura për të filluar procesin e numërimit. Rezulton se ky proces nuk kishte filluar në afatet ligjore në [KZAZ](#)-te 21, 26, 29, 33, 38, 39, ndërsa numërimi ka filluar në orët e vona të mëngjesit të datës 24 Qershor në [KZAZ](#)-të nr. 20, 24, 25, 32, 36, 40, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86. Në të gjitha [KZAZ](#)-të e monitoruara pati ndërprerjeje të herëpashershme, të cilat u justifikua me lodhjen e anëtarëve të grupeve të numërimit.

Vlen të përmendet se në 7 [KZAZ](#) u vërejt pjesëmarrja e personave të paautorizuar në ambientet e numërimit, përkatësisht në [KZAZ](#) 21, 27, 33, 34, 38, 78, 79, 81, 82, 84, 85 dhe 86. Në të shumtën e rasteve, këta persona u nxorën jashtë nga anëtarët e [KZAZ](#)-së dhe në disa raste u nevojiti edhe ndërhyrja e policisë për këtë qëllim. Një aspekt tjetër i vërejtur ishte pamundësia e identifikimit të të gjithë personave të paautorizuar në të gjitha [KZAZ](#)-të e monitoruara, për shkak të mos mbajtjes së bexhave në mënyrë të dukshme.

Vijueshmëria e procesit të numërimit ka qenë normale dhe është zhvilluar kryesisht në një klimë të qetë. Është pozitiv fakti që, krahasimisht me zgjedhjet e kaluara, nuk janë evidentuar zvarritje të gjata të pamotivuara. Një aspekt tjetër pozitiv ka qenë qetësia dhe maturia që kanë treguar grupet e numërimit të votave gjatë kryerjes së detyrës, si dhe konsensusi tyre në vendimmarrje, pa anashkaluar ligjin. Anëtarët e [KZAZ](#)-ve kanë treguar mirëkuptim për zgjidhjen problemeve dhe kapërximin e pengesave të ndryshme, që u hasën gjatë procesit të numërimit. Megjithatë nga hapja dhe verifikimi i disa kutive me materiale të votimit, gjatë procesit të shqyrtimit të ankimeve të subjekteve zgjedhore, rezultuan edhe pasaktësi të pasqyrit të numërit të votave në dokumentacionin përkatës, të cilat, gjithsesi, nuk ndikuan në ndryshimin e rezultatit zgjedhor.

Për sa i takon kontestimeve dhe kundërshtimeve, lidhur me procedurat gjatë procesit të numërimit të votave, ato u vërejtën më së shumti në 30 [KZAZ](#)-të nr. 3, 5, 21, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 47, 48, 49, 50, 51, 59, 60, 78, 79 dhe 80. Kontestimet dhe kundërshtimet janë bërë kryesisht nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore dhe kishin të bënin me aspekte që i takojnë vlefshmërisë së fletëve të votimit, kalimit të tyre të shpejtë në monitorin e transparencës, ose pozicionimin e gabuar të fletëve të votimit në monitor. Në përgjithësi, kontestimet janë marrë në konsideratë nga anëtarët e [KZAZ](#)-së dhe vetëm në 3 [KZAZ](#) ato nuk janë pasqyruar në procesverbal, me arsyetimin se kanë qenë pak të rëndësishme.

Në 6 [KZAZ](#), vëzhguesit e KShH-së konstatuan se janë ushtruar ndërhyrje ndaj [GNV](#)-ve dhe anëtarëve të [KZAZ](#)-së, konkretisht në [KZAZ](#)-të Nr. 21, 29, 30, 32 dhe 38. Ndërhyrjet ushtroheshin shpesh nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhorë, të cilët në mjaft raste kontestonin vlefshmërinë e fletëve të votimit,

por duke e bërë vërejtjen e tyre jo në mënyrat e parashikuara në ligj. Gjatë procesit të numërimit, në disa [KZAZ](#), u konstatuan incidente si ato me [KZAZ](#)-të nr. 21, 30, 32, 33, 34, 35, 38, 48, 78 dhe 81, të cilat kishin natyrën e debatimit të acaruar midis vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe anëtarëve të [KZAZ](#)-ve, si dhe midis vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe anëtarëve të [GNV](#)-ve. Vlen të përmendim se në disa raste është dashur kërkimi i ndihmës së organeve të policisë për të qetësuar situatën, si në [KZAZ](#)-në nr. 34²⁷, [KZAZ](#) 38²⁸, në [KZAZ](#) 33²⁹.

5. TRASPARENCA E PROCESIT ZGJEDHOR

Lidhur me transparencën e procesit zgjedhor standardet e Kopenhagenit përcaktojnë se shtetet pale vlerësojnë se prezenca e vëzhguesve, si të atyre të huaj apo vendas, mund ta përmirësojë procesin zgjedhor të vendit ku mbahen zgjedhjet. Ato do të bëjnë të mundur që asnjë pengesë ligjore ose administrative të mos kufizojë aksesin e mjeteve të informacionit, mbi baza jodiskriminuese, tek të gjitha grupet politike dhe individët që mendojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Aksesi i vëzhguesve të shoqërisë civile në [QV](#)-të e vendit në përgjithësi ka qenë i mirë. [KOZ](#) akreditoi mbi 9000 vëzhgues, vendas e të huaj, një numër ky tepër i madh në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Megjithatë u vërejtën edhe disa probleme si p.sh. disa vëzhgues nuk janë lejuar nga komisioni i [QV](#) të asistojnë në procedurat e hapjes së votimit, ose janë nxjerrë jashtë në momentet kur është pezulluar votimi, si në Tiranë [QV](#) 1797, 1410/2, 1410, në Librazhd [QV](#) 2706, në Vlorë [QV](#) 4473, etj. Pengimi është bërë pa dhënë asnjë arsye të përligjur, ndonëse vëzhguesit ishin rregullisht të akredituar nga [KOZ](#). Më problematike në këtë drejtim u paraqitën [KZAZ](#) nr. 32, 36 dhe 84. E shprehur në shifra situata tregon se në 99.19% të rasteve në [QV](#)-të e monitoruara vëzhguesit kanë pasur akses të plotë dhe në 0.81% ata nuk janë lejuar për të hyrë lirisht në qendrën e votimit.

Vëzhguesit e KShH-së kanë hasur pengesa në monitorimin e këtij procesi dhe në disa raste nuk janë lejuar të hyjnë në vendin e numërimit me arsyetimin se bexha e akreditimit të [KOZ](#)-së nuk ishin të mjaftueshme dhe nevojitej edhe një autorizim nga anëtarët e [KZAZ](#)-së. Pengesat u hasën në [KZAZ](#) 32, 36, 38, 59 dhe 84. KShH pati kontakte të vazhdueshme me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe falë ndërhyrjeve të tij, në disa raste, u bë e mundur hyrja e vëzhguesve të KShH-së në këto ZAZ.

Në 17 [KZAZ](#) (Nr.3, 24, 25, 27, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 38, 39, 40, 59, 60, 80, 81, 84) aksesi i vëzhguesve të KShH-së ishte i kufizuar për të monitoruar rregullshmërinë e procedurave të numërimit. Arsyet kryesore të këtij kufizimi ishin të ndryshme, konkretisht: papërshtatshmëria e ambienteve ku ishin vendosur grupet e numërimit të votave, të cilat kishin kubaturë të vogël që nuk i përgjigjej nevojave të procesit dhe numrit dhe të monitorimit nga vëzhguesit; mungesa e ajrimit; zhurma ose pengesa në shikueshmëri për shkak të reagimeve të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore; problematikat lidhur me logjistikën e numërimit, përkatësisht defektet e monitorëve ku shfaqeshin fletët e votimit, largësisë së monitorëve nga vendi ku qëndronin vëzhguesit, mungesa e karrigeve për vëzhguesit; probleme me foninë e zërit në tavolinat e grupeve të numërimit, etj.

Aksesi i medieve në procesin e votimit e të numërimit të votave ka qenë i mirë. Ato kanë informuar gjerësisht opinionin publik rreth zhvillimit të të gjitha fazave të procesit zgjedhor, ndonëse është vënë

²⁷ Ku një person i paautorizuar u fut brenda zonës së numërimit, kërcënoi dhe qëllloi një nga anëtarët e [GNV](#). Me vendim të [KZAZ](#)-së ndërhyrë forcat e policisë të cilat vendosën qetësinë në këtë [KZAZ](#).

²⁸ Në këtë [KZAZ](#) vëzhguesit janë nxjerrë jashtë nga forcat e policisë për disa orë dhe nuk janë lejuar të monitorojnë procesin. Në [KZAZ](#)-në 48 është ndërprerë procesi i numërimit me kërkesë të vëllait të kandidatit të Partisë Demokratike i cili ishte pjesë e [KZAZ](#)-së.

²⁹ Janë vërejtur gjatë gjithë kohës probleme, si mosmarrëveshjet midis komisionerëve dhe anëtarëve të grupeve të numërimit, po ashtu edhe midis forcave të policisë dhe disa prej deputetëve prezent aty. Jashtë ambienteve të kësaj [KZAZ](#)-je u konstatua një person civil i armatosur, i cili shkaktonte një situatë frike dhe pasigurie për të gjithë personat prezent aty, ndërkohë që në atë kohë nuk kishte punonjës të policisë në këto ambiente.

re edhe një farë qasje e paracaktuar e medieve me subjekte zgjedhore në konkurrim. Mediet nga ana e tyre i kanë bërë pasqyrim të gjerë të gjithë veprimtarive të procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë fushatën zgjedhore, ditën e votimit dhe numërimin e votave. Ato përveç hapësirave për të analizuar procesin me analistë të mirënjohur kanë ofruar hapësirë edhe për përfaqësues të shoqërisë civile që monitoruan këtë proces zgjedhor, duke u dhënë mundësi të flasin për konstatimet e tyre. Udhëzimi i [KQZ](#) për pasqyrimin e fushatave zgjedhore me materialet e përgatitura nga vetë subjektet zgjedhore cenoi pavarësinë editoriale të medieve, si dhe të drejtën e informimit të shtetasve, të cilët kanë të drejtë të njihen me zhvillimet në vend në mënyrë sa më objektive. Nuk kanë munguar dhe incidente, si ai me kameramanët dhe gazetarët e Top Channel, të cilët janë dhunuar dhe u janë dëmtuar pajisjet..

Lidhur me mangësitë në transparencën e procesit zgjedhor ka përgjegjësi direkt dhe [KQZ](#). Faqja zyrtare e këtij organi nuk ka qenë operative gjatë gjithë procesit zgjedhor, d.m.th menjëherë pas konstituimit të [KQZ](#) dhe dekretimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës. Aktet normative, veçanërisht Udhëzimet nuk janë pasqyruar menjëherë dhe ndonjëherë nuk janë publikuar të plota. Udhëzimet e Ministrisë së Brendshme lidhur me hartimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë dhe listave të zgjedhësve nuk janë bërë publike as në faqen zyrtare të MB dhe as në atë të [KQZ](#). Transparenca e procesit zgjedhor nuk është bërë në nivelin e duhur nga [KQZ](#) veçanërisht gjatë ditës së votimit dhe gjatë procesit të numërimit të votave.

6. KONKLUSIONE

Bazuar në gjetjet e pasqyruara në këtë raport të monitorimit të zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka arritur në përfundimet si më poshtë vijon:

1. Në zgjedhjet e zhvilluara në 23 Qershor 2013 u shënuan përmirësime të ndjeshme në drejtim të cilësinë e listës së zgjedhjeve, në drejtim të respektimit të procedurave të procesit të votimit ashtu dhe në atë të numërimit të votave, si dhe u vërejt se janë hedhur hapa pozitivë në drejtim të pranimit dhe vlerësimit të përshtatshëm të diversitetit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor.
2. Kontestimet në këto zgjedhje kanë qenë, relativisht më të pakta, si pasojë e veprimtarisë më të mirë, e më të përgjegjshme të [KZAZ](#)-ve, [KQV](#)-ve dhe grupeve të numërimit të votave.
3. Përmirësime u arritën edhe në ushtrimin të funksioneve nga policia e shtetit, gjatë kohës së zhvillimit të votimit, shoqërimit të materialeve për në vendet e numërimit të votave dhe gjatë procesit të numërimit të tyre. Megjithatë këto organe duhet të kishin punuar më mirë në drejtim të ruajtjes së rendit e qetësisë gjatë periudhës së përgatitjeve të zgjedhjeve, për të parandaluar e goditur kriminalitetin e manifestuar.
4. Meritë e veçantë, në këtë proces zgjedhor, u takon zgjedhësve, që në mënyrë të qetë dhe të vullnetshme ushtruan të drejtën e tyre të votës. Pjesëmarrja e tyre në votim konsiderohet e kënaqshme, në kushtet kur një përqindje e lartë e zgjedhësve të vendit tonë ndodhen në emigracion.
5. Subjektet zgjedhore, sidomos shumica qeverisëse, duhet të mbante më mirë parasysh faktin se OSBE/ODHIR vazhdimisht ka artikulluar kritika për shfrytëzimin e inaugurimeve për qëllime elektorale, ose përdorimin e administratës publike dhe nxënësit e shkollave në veprimtari zgjedhore, gjë që bie ndesh me paragrafin 5 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990.
6. [KQZ](#), megjithëse ka përballuar një volum të madh pune, nuk ka qenë gjithmonë në lartësinë e kryerjes së detyrës dhe në disa raste, në kuadër të marrjes së vendimeve, u është nënshtruar ndikimeve politike. Veprimtaria e [KQZ](#) u dobësua, u kufizua dhe u politizua edhe më tepër, sidomos pas largimit, me dorëheqje, të tre anëtarëve dhe reduktimit të [KQZ](#)-së me 4 anëtarë.
7. Parregullsitë, ose mospërmblidhjet më të theksuara të standardeve u konstatuan në drejtim të edukimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve, në respektimin e normave për zhvillimin e fushatës nga subjektet zgjedhore, si dhe në veprimtarinë e [KQZ](#). Megjithatë këto mangësi nuk ishin të tilla sa për t'i bërë të papranueshme zgjedhjet e 23 Qershorit 2013.

8. Duke pasur parasysh ecurinë e periudhës para zgjedhore, të metat dhe shkeljet e ligjit të konstatuara gjatë procesit të votimit, të numërimit të votave, mendojmë se duhen bërë përpjekje më të mëdha jo vetëm për zbatimin rigoroz të ligjit, por edhe për të pasur një vullnet më të mirë politik në këtë drejtim, sidomos nga dy partitë më të mëdha të vendit.
9. Mbetet detyrë e rëndësishme e Kuvendit të Shqipërisë, përmirësimi i mëtejshëm i Kodit Zgjedhor, rishikimi i mundësisë për depolitizimin e organeve të administrimit zgjedhor, si dhe përmirësimi i veprimtarisë së tyre në drejtim të ushtrimit të kompetencave që u cakton ligji, veçanërisht në procesin e numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultateve.


Falënderime

Stafi i KShH dhe monitoruesit tanë të mrekullueshëm, kanë kryer me sukses dhe korrektësi detyrën e tyre dhe për këtë i falënderojmë sinqerisht. Gjithashtu një falënderim u shkon donatorëve tanë, Ambasadën Amerikane në Shqipëri, organizatën suedeze [CRD](#) dhe Fondacioni për Shoqërinë e Hapur (Soros), të cilët me mbështetjen e tyre financiare bënë të mundur këtë monitorim. Falënderojmë organizatën [FSHDPAK](#) për bashkëpunimin e sinqertë dhe profesional, si dhe të gjitha institucionet e pushtetit qendror e vendor, që na pritën e na dhanë gjithë informacionin e kërkuar, ose u treguan të hapur ndaj vërejtjeve dhe sugjerimeve që ne ju ofruam. Falënderojmë gjithashtu organet e administrimit të zgjedhjeve, të të gjitha qarqeve që kemi monitoruar, për mirëkuptimin e tyre.


7. DOKUMENTE TË ANEKSUARA

A. Përmbledhje e të dhënave dhe grafikëve mbi gjetjet e KShH

Grafiku 1 – Prezenca e anëtarëve të KQV-ve në orën 6:00 Në 16.07% të QV të monitoruara anëtarët s'kanë qenë prezent në orën 6:00.




Grafiku 2 – Qendra e votimit në gjëndje të rregullt




Grafiku 3 - Anëtarët femra te KQV-ve


Në 16.98% të rasteve në QV-të e monitoruara nuk kishte asnjë anëtare femër. Në 0.74% të rasteve 6 anëtare ishin femra. (Në 22.06% të rasteve 1 anëtare ishte femër; 33.33% të rasteve 2 femra; 17.84% të rasteve 3 femra; 6.69% të rasteve 4 femra; 2.35% 5 femra).




Grafiku 4 - Sa kryetar të [KQV](#)-ve ishin femra




Grafiku 5 - Vendosja ne pozicionin e duhur të dhomës së fshehtë të votimit.




Grafiku 6 - Materialet propagandistike ne Qëndrën e votimit deri 150 metra përreth.




Grafiku 7 - Marrja e vendimit për hapjen e votimit.




Grafiku 8 - Aksesi i vëzhguesve në QV për monitorim




Grafiku 9 - Vëzhguesit e tjere




Grafiku 10-Rradha e votuesve në qendrën e votimit




Grafiku 11 - A tregon zgjedhësi dokumentin e identifikimit kur hyn në qendrën e votimit.




Grafiku 12- Verifikimi i emrit të zgjedhësit me listën e zgjedhësve dhe dokumentin e identifikimit




Grafiku 13- Kontrolli i zgjedhësve për timbrosjen




Grafiku 14- Timbrosja e zgjedhësve



Grafiku 15 – Lejimi për të votuar i personave të timbrosur më parë




Grafiku 16-17-Votuesve që iu mohua e drejta e votës




Në 18.56% të rasteve që nuk u lejuan të votojnë ishin për arsyet e mëposhtme:

- Në 16.67% të rasteve në QV-të e monitoruara iu mohua e drejta e votës dhe nuk mundën të votonin për arsye se kishin pasaktësi në regjistrimin e emrit në liste.
- Në 14.74% të rasteve nuk mundën të votonin për arsye se kishin mjet identifikimi të pavlefshëm.
- Në 6.41% të rasteve nuk mundën të votonin sepse ndryshonte mbiemri në listën e votuesve me kartën e ID-së për arsye celebrimi.
- Në 51.28% të rasteve nuk mundën të votonin pasi nuk e kishin emrin në listën e votuesve. Në 8.33% të rasteve nuk mundën të votonin për shkak të pasaportës së vjetër ose mjetit të identifikimit. Në 2.56% të rasteve nuk mundën të votonin për shkak se u kapën duke fotografuar votën.




Grafiku 18 - Votim familjar




Grafiku 19 - Presioni ndaj votuesve

Në 99.44% të rasteve në QV-të e monitoruara nuk është ushtruar presion ndaj votuesve, ndërsa në 0.56% të rasteve është ushtruar presion ndaj tyre.




Grafiku 20-nderhyrje ndaj anëtarëve të [KQV](#)-së

Në 98.99% të rasteve në [QV](#)-të e monitoruara nuk është ushtruar presion ndaj anëtarëve të [KQV](#)-së, ndërsa në 1.01% të rasteve është ushtruar presion ndaj tyre.




Grafiku 21-22- Tensioni gjatë procesit të votimit në QV

Në 94.06% të rasteve në [QV](#)-të e monitoruara nuk ka patur tension gjatë procesit të votimit, ndërsa në 5.94% të rasteve ka patur tension.




Rastet kur janë evidentuar tension, komunikim i ashpër dhe dhe kaos ne QV

Në 21.88% të rasteve në QV-të e monitoruara është krijuar tension dhe debat për shkak të personave ose vëzhguesve të subjekteve politike, 37.50% si pasojë e debateve të komisionerëve me vëzhguesit partiak ose votuesit, 3.12% si pasojë e komunikim verbal midis anëtarëve të komisionit, 9.38% si pasojë e rradhës së krijuar, 21.88% si pasojë e vonës në hapjen e procesit të votimit, 6.28% si pasojë e votimit familjar.




Grafiku 23 -Lëshimet nga KQV-ja dhe natyra e tyre

Në 95.63% të rasteve në QV-të e monitoruara nuk ka patur fare lëshime. Në 3.64% të rasteve janë lejuar parregullsi (0.21% të rasteve parregullsi nga vetë anëtarët e komisionit, në 0.31% të rasteve kanë lejuar votimin familjar, në 0.10% lejuan militantët të sjellin votues deri në momentin e hedhjes së firmës, në 0.10% lejuan vëzhguesit e subjekteve të ndërhyjnë gjatë procesit), etj




Grafiku 24- Problemet e lindura gjatë votimit

Në 97.28% të rasteve në QV-të e monitoruara nuk ka patur asnjë problem gjatë votimit. Ndërsa në 0.10% të rasteve është ushtruar dhunë verbale ndaj një komisionerëve dhe debate në komision, në 0.21% të rasteve është bërë fotografim i votës nga një votues, në 2.09% ka patur probleme me emrat, nuk gjenin QV-ne, në 0.31% të rasteve ka patur votim familjar.




Grafiku 25- Aksesi i vëzhguesve për të ndjekur procedurat e KQV-së

Në përgjithësi vëzhguesit e KSHH-së kanë patur akses në qendrat e votimit të të gjitha qarqeve, me përjashtim të pakta si në Tiranë, Korçë dhe Elbasan.



Grafiku 26-Ndërhyrjet me shkrim të vëzhguesve pranë KQV-së


Në 93.82% të rasteve në QV-të e monitoruara vëzhguesit nuk kanë bërë vërejtje me shkrim pranë KQV-së, ndërsa në 6.18% ata kanë bërë.



Arsyet e vërejtjeve me shkrim (58 vërejtje drejtuar KQV-ve dhe KZQZ-ve) kanë qënë problematika të ndryshme të evidentuara si procedura të parregullta të ndjekura gjatë procesit të hapjes së votimit dhe gjatë procesit të votimit, respektimi I të drejtës së votës, etj.


Grafiku 27- Menura e transportimit te materialeve zgjedhore

Në të gjitha rastet materialet e votimit dhe kutitë me fletët e votimit janë dërguar në VNV brenda afatit të përcaktuar. Në disa raste materialet kanë shkuar me makinë dhe në raste kur vendondodhja e VNV-ve ka qënë afër I kanë transportuar në këmbë.




Grafiku 28- Situata ne momentin e transportit te materialeve

Në 99.68% të rasteve gjëndja në momentin kur kutitë e votimi dhe me materialet e votimit janë futur në makinë për tu dërguar në QV ka qenë e qetë dhe pa incidente. Ndërsa në 0.32% të rasteve gjëndja ka qenë e acaruar e me debate.




Grafiku 29 - Kushtet e procesit të votimit në QV

Në 56.75% të rasteve kushtet e procesit të votimit kanë qenë shumë të mira. Në 0.76% të rasteve në QV-të e monitoruara kushtet e procesit të votimit kanë qenë të këqija. Në 7.41% të rasteve kushtet kanë qenë të mjaftueshme. Në 35.41% të rasteve kushtet kanë qenë të mira.



Grafiku 30-Transparenca e procesit të votimit

Në 100% të [QV](#)-ve të monitoruara ka pasur nivel të lartë transparence përsai përket procesit të votimit.



B. Raporti i veçantë në lidhje me situatën e respektimit të të drejtës së votës për zgjedhësit me aftësi të kufizuara dhe statistika për këtë qëllim



E drejta e votës për zgjedhësit me aftësi të kufizuara

Rezultate vëzhgimi
Zgjedhjet Parlamentare
23 Qershor 2013

Tiranë, Korrik 2013

TABELA E LENDES

Hyrja

Përmbledhje Ekzekutive

METODOLOGJIA.....

Pjesëmarrësit.....

Instrumentat & Materialet.....

Procedura.....

Analiza Statistikore.....

Etika në realizimin e studimit.....

REZULTATE

DISKUTIME & KONKLUSIONE

REKOMANDIME

LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---------|---|
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| FSHDPAK | Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara |
| KSHH | Komiteti Shqiptar i Helsinkit |
| QV | Qendër Votimi |
| KQZ | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |

HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si edhe Kodi Zgjedhor sanksionojnë të drejtën për të marrë pjesë në proceset zgjedhore si zgjedhës dhe si të zgjedhur, për të gjithë shtetasit, përfshirë këtu edhe zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Për zgjedhësit me aftësi të kufizuara kjo e drejtë është e shprehur edhe në Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara si edhe në Konventën e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Përmirësimet e Kodit Zgjedhor, që nga viti 2002 e në vijim ndryshuan cilësisht mundësinë e votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, nga mënyra e votimit vetëm nëpërmjet shoqëruesit (deri në vitin 2002), në alternativën edhe për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në votime për zgjedhësit me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim, duke krijuar lehtësirat në mjete dhe shërbime (në përmirësimet e Kodit Zgjedhor në 2003).

Megjithë këto përmirësime, e drejta zgjedhore e zgjedhësve me aftësi kufizuara mbetet ende e cënuar, sepse është lehtësuar pjesëmarrja vetëm e zgjedhësve që arrijnë të shkojnë në qendrën e votimit e të votojnë para komisionit zgjedhor.

Përmes disa monitorimeve në proceset zgjedhore pas vitit 2000, nga grupe të caktuara të vëzhguesve me aftësi të kufizuara, të organizuara nga [FSHDPAK](#), një tërësi rezultatesh tregojnë se ishte numër i konsiderueshëm zgjedhësish me aftësi të kufizuara të cilëve u mohohet e drejta e barabartë dhe e fshehtë e votimit, jo vetëm për shkak të kufizimeve ligjore, por sepse një pjesë prej tyre nuk dilnin dot nga shtëpia për të shkuar për të votuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe kjo ishte në shifrat e 11.3 % të votuesve³⁰.

Në zhvillimet e fundit ndërkombëtare, miratimi nga OKB i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2006, shënoi një fillim të ndryshimeve në kuadrin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët fuqizuan më tej kërkesat ndaj qeverive për respektimin dhe përmbushjen e këtyre të drejtave, duke filluar nga të drejtat politike e sociale. Ratifikimi nga ana e shtetit shqiptar, në Dhjetor 2012, të kësaj Konvente krijon detyrime të reja të qeverisë shqiptare edhe në drejtim të ndryshimeve ligjore dhe praktikave administrative për të mundësuar realisht pjesëmarrjen në votime të të gjithë zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

Nuk ka shifër zyrtare se sa persona me aftësi të kufizuara janë votues. Duke iu referuar statistikave të marra nga INSTAT mbi grup moshat e popullsisë³¹, janë afërsisht 134 mijë persona në moshë votimi, që do të thotë rreth 97 % e tyre ose 6.05% e popullsisë. Nëse llogarisim edhe pjesëtarë të familjeve të personave me aftësi të kufizuara me të drejtë vote, rritet disa herë potenciali i tyre për të ndikuar në vendimarrje, përmes mekanizmit të votës.

³⁰ Mindes, J., IFES :Zgjedhje Vendore 2003 në SHqipëri : Një Vështrim mbi Zgjedhësit që nuk mund të lëvizin nga shtëpia, e Hospitalizuar dhe me Aftësi të Kufizuara

³¹ Censusi i Popullsisë dhe Banesave, 2011

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë se pjesëmarrja e tyre në proceset zgjedhore është një mënyrë që ndikon në përshtetimin e integritetit të tyre, ku nëpërmjet mekanizmit të votës, ndikojnë tek politikëbërësit në hartimin e politikave dhe ligjeve që realisht luajnë rol në përmirësimin e cilësisë së jetesës për ta dhe familjarët e tyre.

Ky raport vëzhgimi synon të sjellë informacion në lidhje me mundësitë reale që kanë personat me aftësi të kufizuara, të të gjitha kategorive, për ta ushtruar të drejtën e votës, si edhe për angazhimin e strukturave përgjegjëse për të siguruar lehtësirat e domosdoshme, konform ligjit.

Vëzhgimi u realizua në ditën e votimit për zgjedhjet parlamentare të 23 Qeshorit 2013, në katër rajone, Tiranë, Elbasan, Shkodër e Durrës. U vëzhguan 387 qendra votimi nga vëzhguesit e [FSHDPAK](#) dhe KSHH. 37 % e vëzhguesve ishin persona me aftësi të kufizuara ose familjarë të tyre.

Rezultatet e vëzhgimit treguan për një ndërgjegjësim të lartë të komisioneve zgjedhore për të mirëpritur e orientuar zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Vazhdon të mbetet ende problem mosvendosja e [QV](#) në katet e para (përdhe) të ndërtesave, 20% e tyre ishin në katet e sipërme. Njësitë e pushtetit vendor ende nuk e kanë përgjegjësinë e plotë për të zgjedhur për qendra votimi objekte me hyrje të përshtatur, duke bërë që rreth 60% e tyre të ishin në objekte me hyrje me shkallë. Edhe vlera 79% e qendrave që nuk ishin pajisur nga [KOZ](#) me dhomë fshehtësie të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara tregon për masa jo të plota përgatitore. Ndërkohë që vetëm 15.5% e zgjedhësve me aftësi të kufizuara që votuan, ishin identifikuar paraprakisht si të tillë, duke kufizuar kështu vemendjen e njësisve vendore për të marrë masat lehtësuese.

Mungesa e mjeteve të posaçme të votimit për të verbërit, bëri që 86 % e personave të verbër (verbëri e plotë) të votonin nëpërmjet asistentit, duke çënuar kështu parimin e fshehtësisë së votës. 86 % e personave me probleme dëgjimi nuk patën ndërmjetësimin e interpretit të gjuhës së shenjave për të patur informacion plotësues gjatë votimit, gjë që i vendoi ata para dilemës nëse kishin shprehur realisht dëshirën e tyre gjatë votimit.

Vëzhgimi evidentoi gjithashtu edhe raste sporadike të zgjedhësve me aftësi të kufizuara që tentuan të votojnë jashtë qendrës së votimit.

Rekomandimet, bazuar mbi rezultatet e këtij vëzhgimi, synojnë të orientojnë për përmirësime ligjore dhe zgjidhje administrative në lidhje me përmirësime ligjore mbi ndarjen e përgjegjësisve institucionale për të lehtësuar votimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive dhe alternativa për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia për të votuar, për shkak të aftësisë së kufizuar; marrjen e masave në drejtim të organizimit të shërbimeve parazgjedhore e zgjedhore për zgjedhësit me aftësi të kufizuara për identifikimin e tyre në lista, për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për këtë të drejtë, transportin e përshtatur për në qendrat e votimit, përzgjedhjen e [QV](#) të përshtatura dhe/ ose përshtatjen e tyre dhe pajisjen me mjete të posaçme votimi për të verbërit dhe sigurimin e mbështetjes me interpret të zgjedhësve me probleme dëgjimi.

METODOLOGJIA

Pjesëmarrësit

Procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve parlamentare të 23 Qershorit 2013 u vëzhguar edhe specifikisht në lidhje me aksesin që ofronte ky proces për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. 387 qendra votimi u vëzhguan nga 163 vëzhgues të [FSHDPAK](#) dhe KSHH, të cilët sollën informacionin e tyre nga katër qytete dhe respektivisht nga qendrat e votimit në Tiranë (n= 231, 59.7%), në Elbasan (n=52, 13.45%), në Shkodër (n=74, 19.1%) dhe në Durrës (n=30, 7.8%)




Figura 1. Qendrat e vëzhguara sipas qyteteve

Instrumentat & Materialet

Për marrjen e informacionit në lidhje me aksesin që ofronte procesi zgjedhor për zgjedhësit me aftësi të kufizuara u përdor një pyetësor specifik, me 13 pyetje të mbyllura, ku vëzhguesit klikuan alternativën që përputhej me situatën gjatë procesit të votimit.

Pyetësi u përgatit nga stafi i [FSHDPAK](#).

Procedura

Të gjithë vëzhguesit u trajnuan paraprakisht para ditës së votimit, në trajnime të përbashkëta të organizuara nga [FSHDPAK](#) dhe KSHH. Të dhënat u mblodhën në ditën e votimit, 23 Qershor 2013, me qëndrim të vëzhguesve pranë qendrave të votimit që nga hapja e deri në mbylljen e tyre.

Analiza Statistikore

Të dhënat e mblidhura përmes pyetësorëve sasiorë u hodhën e më pas u përpunuan në SPSS (versioni 17.00). Variablat ishin nominale kryesisht, kështu që u analizuan përqindjet dhe frekuenca.

Etika në realizimin e studimit

Të gjithë vëzhguesit pranuan me vullnetin e tyre të lirë që të jenë pjesë e procesit të vëzhgimit zgjedhor dhe të mblidhnin të dhëna përmes pyetësorëve. Vëzhguesit u akredituan nga [KQZ](#) dhe gjithashtu ata nëshkruan një zotim për të raportuar me saktësi dhe vërtetësi mbi çdo konstatim në ditën e votimit

REZULTATE

Në 387 qendrat e votimit të vëzhguara në rajonet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Elbasanit rezultoi se pothuajse të gjitha komisionet e votimit mbajtën qëndrim pozitiv ndaj votuesve me aftësi të

kufizuara dhe specifikisht 48.6% e komisioneve kanë mbajtur qëndrim normal dhe 37.0% kanë qenë mikpritës, më e spikatur kjo në Tiranë dhe Durrës, ku ishte një qëndrim totalisht normal dhe pozitiv, ndërsa në Elbasan dhe në Shkodër kishte në përqindje të ulët edhe qëndrim fyes e indiferent (3.8 % dhe 2.7 % të rasteve).

Në lidhje me vendosjen e qendrave të votimit brenda objekteve të përzgjedhura, rezultoi se 80.9% (n=313) të qendrave të votimit ishin të vendosura në katet e para (përdhe) të ndërtesave; 17.5 % (n=68) e tyre në katet e dyta dhe 1.6% (n=6) në katet e treta. Shih figurën 2.

Këtu numrin më të madh të qendrave të vendosura në katet e para e kishte Tirana me 56.2% të qendrave që u vëzhguan në Tiranë, por që kishte edhe përqindjen më të lartë të qendrave të vendosura në katet e dyta me 72.1 % të rasteve ndër katër rajonet, si edhe u konstatuan 6 qendra votimi në Tiranë, të vendosura në katet e treta.




Figura 2. Vendosja e qendrave të votimit në nivele të ndryshme katesh

U konstatua ende shumë i lartë, në shifrën 62.3% (n=241) të tyre, numri qendrave të votimit që ishin caktuar në objekte me hyrje të papërshtatura, me shkallë. Shih figurën 3.




Figura 3. Niveli i aksesit në hyrje të qendrave të votimit

Ndërkohë që në Tiranë rezultoi përqindja më e ulët e qendrave me hyrje të përshtatur, 34.2% e totalit të vëzhguar në Tiranë, kundrejt Shkodrës që kishte 45.9 % të objekteve qendra votimi me hyrje të përshtatur.

Po ashtu në 78.8% (n=305) të qendrave të votimit u vërejt mungesa e dhomave të fshehtësisë të përshtatura për përdoruesit e karrigeve me rrota. Ishte Elbasani me numrin më të madh të qendrave të votimit (48.1%) të pajisura me dhomë të fshehtësisë të përshtatura, kundrejt Tiranës me 16.5%.

Ishte vetëm 15.5% (n=60) e të gjitha qendrave të vëzhguara, ku zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që votuan në to, ishin identifikuar më parë në listat e zgjedhësve. Ndër to Tirana dhe Durrësi kishin % më të ulët të qendrave ku zgjedhësit me aftësi të kufizuara ishin identifikuar paraprakisht në lista me 26.7 % dhe 3.3 % respektivisht, kundrejt 40% në Shkodër dhe 30 % në Elbasan. Figura 4.




Figura 4. Përqindja e QV, sipas qyteteve, ku zgjedhësit me aftësi të kufizuara ishin identifikuar në lista

Gjatë procesit të vëzhgimit u evidentuan që morën pjesë në votim, në 387 qendrat e vëzhguara, në total 1403 persona me aftësi të kufizuara, ku në Tiranë votuan 620 persona, në Durrës 109, në Shkodër 330 dhe në Elbasan 344. Figura 5.




Figura 5. Pjesëmarrja në votim e personave me aftësi të kufizuara sipas rajoneve

Ndër këta persona, 519 ishin me aftësi të kufizuara në lëvizje; 379 me aftësi të kufizuara në shikim; 262 me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe 243 me aftësi të kufizuara intelektuale. Figura 6.




Figura 6. Pjesëmarrja në votim e personave me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar

Në lidhje me mënyrën e votimit të zgjedhësve rezultoi se nga zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike që morën pjesë në votime, 65.1 % e tyre votuan vetë, pa asistencë; nga ata me probleme shikimi 14.2 % votuan vetë, pa asistencë; ndër ata me aftësi të kufizuara intelektuale, 75.7 % e tyre votuan vetë, pa asistencë. Ndërsa zgjedhësit me probleme dëgjimi vetëm 14% e tyre votuan me praninë e interpretit të gjuhës së shenjave, duke bërë që pjesa tjetër të mos ishte e sigurt në vlefshmërinë e votës së tyre. Shih figurën 7.




Figura 7. Përqindja e votimit në mënyrë të drejtpërdrejtë për kategori të ndryshme të zgjedhësve me aftësi të kufizuara

Tek kategoritë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim ishte e lartë % e votimit me asistencë. Kështu për ata me aftësi të kufizuara fizike, në Shkodër ishte numri më i lartë, 56.8 % e tyre që votuan me asistencë, për ata me aftësi të kufizuara në shikim në përqindje më të lartë ishin në Durrës, 90.0%.

Ndërkohë që u mungoi mbështetja me asistencë / përkthyes të gjuhës së shenjave, personave me probleme dëgjimi dhe ndër 14 % e numrit të përgjithshëm që patën asistencë, 1.3% e tyre ishin në Durrës, 2.3% në Shkodër, 3.6% në Elbasan dhe 6.7% në Tiranë. Edhe personat me aftësi të kufizuara

intelektuale në % më të lartë zgjedhën të votojnë vetë, duke filluar nga 5 persona në Durrës, në 49 të tillë në Tiranë.

DISKUTIME & KONKLUSIONE

Vëzhgimi i procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve parlamentare të 23 Qershorit 2013 tregoi disa hapa pozitivë që shoqëria po hedh për pranimin dhe vlerësimin e diversitetit në shoqëri. Këtë e shprehu edhe qëndrimi pozitiv i 85 % të komisioneve në qendrat e votimit ndaj votuesve me aftësi të kufizuara. Kjo edhe për faktin se [KQZ](#) kishte bërë pjesë të moduleve të trajnimit të komisionerëve edhe çështje në lidhje me zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që vetëm në 2 komisione në Shkodër dhe 1 në Elbasan kishte raste fyese dhe indiferente, këto në zonat rurale, ku edhe ndërgjegjësimi është më i ulët.

Edhe pse Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve kishte nxjerrë Udhëzimin nr. 1, datë 12.12.2012 për njësitë e pushtetit vendor në lidhje me vendosjen e qendrave të votimit vetëm në katet e para (përdhe) të objekteve, përsëri ishin rreth 20% të qendrave të vendosura në katet e sipërme. Këtë nuk e justifikon fakti që [KQZ](#) për të ulur numrin e votuesve në një qendër votimi, rriti numrin e qendrave duke bërë që ato të vendoseshin edhe në katet e larta. Kjo zgjidhje diktoi në disa raste situata ku votues me aftësi të kufizuara, pasi shkuan pranë qendrës së votimit, e cila ishte në kat të dytë, apo të tretë, u kthyen në shtëpi pa votuar, rasti në [QV](#) nr. 314/1, Shkodër dhe një tjetër rast në Tiranë.

"Qendra ime e votimit ishte në katin e tretë të një shkolle dhe edhe pse nuk ishte dëshira ime, vendosa të mos votoj. M'u ofrua alternativa që të më ngrinin në krahë me gjithë karrigen time me rrota, shumë të rëndë sepse është me bateri, nga njerëz të rastësishëm që u ndodhën aty. Nuk pranova jo vetëm se kjo përbënte rrezik, se personat nuk ishin të specializuar, por edhe sepse kjo mënyrë nuk ishte aspak dinjitoze " - thotë I.K, person tetraplegjik, votues në [QV](#) nr. 1900, Tiranë.

Edhe pse [KQZ](#) ka përcaktuar në Udhëzimin e mësipërm, detyrimin për njësitë e pushtetit vendor në lidhje me zgjedhjen e objekteve ku do të vendosen qendrat e votimit, me hyrje të përshtatur, rezultoi e lartë në Tiranë shifra 68.5% me hyrje të papërshtatura.

Në nivele të rreth 60% ishin objektet me hyrje të papërshtatura edhe në rajonet e tjera Durrës, Shkodër dhe Elbasan. Kjo tregon papërgjegjshmëri nga njësitë e pushtetit vendor për marrjen e masave paraprake, por tregon edhe se është i pamjaftueshëm një Udhëzim i vetëm nga [KQZ](#). Është e domosdoshme që ky detyrim për pushtetin vendor të përfshihet dukshëm në Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër përpjekja e [KQZ](#) për të pilotuar ndërtimin e disa rampave në objektet me qendra votimi në Tiranë, Elbasan e Shkodër, rezultoi jo shumë efektive në lidhje me standardin që ofruan këto elemente, që u ndërtuan në një kohë rekord para ditës së votimit. Rezultati do të kishte qënë më shumë në përputhje me standardet nëse do të sigurohej koha e mjaftueshme dhe do të përdorej bashkëpunimi me ekspertë të fushës.

Një masë tjetër që [KQZ](#) ndërmori në periudhën përgatitore për zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit 2013 ishte edhe Vendimi Nr. 9, date 10.01.2013, ku përcaktohet standardi për dhomat e fshehtësisë – të posaçme për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë mungesa e këtyre dhomave të posaçme në 79 % të qendrave të votimit tregoi për mungesë vemendjeje dhe masash konkrete për ta plotësuar këtë detyrim të drejtpërdrejtë të [KQZ](#).

Vetëm 15.5% e zgjedhësve me aftësi të kufizuara kishin arritur të identifikoheshin paraprakisht në listat e votimit pranë njësive të pushtetit vendor. Këtu del në pah një ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i personave me aftësi të kufizuara për t'u vetidentifikuar, sepse këtë detyrim ua adreson kodi zgjedhor. Megjithatë një përgjegjësi kanë edhe njësitë e pushtetit vendor dhe [KQZ](#) që përpjekjen e bërë duke mbledhur informacionin, nuk e finalizuan me rishikim të listave në këtë aspekt. Një përmirësim i Kodit Zgjedhor duhet ta kalojë këtë përgjegjësi të plotë tek njësitë vendore, që në bashkëpunim me [KQZ](#) të rakordojnë për të përcaktuar zonat ku janë të shpërndarë votuesit me aftësi të kufizuara, për të krijuar lehtësira për ta, në shërbime dhe mjete për votim.

Ishte e pranishme mbështetja me asistencë për votuesit e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Nëse do i referoheshim zgjedhësve me probleme lëvizjeje dhe atyre me probleme shikimi, votimi përmes asistentit diktohej nga mungesa e mjeteve dhe shërbimeve të përshtatura. Kështu zgjedhësit e verbër, votuan në % të lartë me asistencë sepse procesi i prodhimit të mjeteve të posaçme për ta nuk arriti të finalizohet nga [KQZ](#), ndërsa 14.2% që votuan vetë i përkisnin grupit me dëmtim të pjesëshëm të shikimit. E kundërta ndodh tek zgjedhësit me probleme dëgjimi, ku prania e interpretit të gjuhës së shenjave është e domosdoshme për të sqaruar procedurat e votimit dhe duhej të ishte 100%, por vetëm 14% e tyre e patën mundësinë e shoqërimit me interpret. Për pjesën tjetër, rreth 76 % nuk u garantua nëse rezultati i votimit përputhej me dëshirën që ata donin të shprehnin në fletën e votimit.

Ndërkohë që pati edhe përpjekje të votuesve "më të guximshëm", të cilët nuk vinin dot për të votuar, të cilët tentuan të bënin votim " në kundërshtim me Kodin Zgjedhor ", si rasti në [QV](#) 2354 në Elbasan që një invalid pune dërgoi një përfaqësues me prokurë për të votuar në emër të tij, por komisioni nuk e pranoi. Apo rasti i një tjetër personi me aftësi të kufizuar, i cili shkoi tek [QV](#), por meqë nuk ngjitej dot se [QV](#) ishte në kat të dytë, detyroi komisionin të zbriste bashkë me fletën dhe kutinë e votimit deri tek hyrja e objektit dhe personi votoi. Këto raste diktojnë marrjen e masave urgjente për gjetjen e zgjidhjeve ligjore alternative për kategorinë e votuesve që nuk dalin dot fare nga banesa.

Në konkluzion të gjetjeve të vëzhgimit do të duhej të theksohej që pavarësisht se nuk u arrit në rezultatet e pritëshme e të premtuara, është hera e parë në të gjitha eksperiencat e proceseve zgjedhore pas vitit 2000, që [KQZ](#) dëgjon dhe merr në konsideratë të gjitha rekomandimet për votuesit me aftësi të kufizuara dhe liston përmbushjen e tyre, duke u angazhuar në mënyrë serioze e duke i përfshirë në problematikat e shtruar për zgjidhje në mbledhjet e [KQZ](#). Por planifikimet jo në kohën e duhur, të lëna për "minutën e fundit", sollën dështimin e disa prej nismave të ndërmarra.

Gjithashtu duhet theksuar se në Kodin Zgjedhor ka një sërë paqartësish, në ndarjen e përgjegjësive institucionale për të lehtësuar votimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Kodi ka edhe mangësi ligjore të cilat madje çojnë edhe deri në diskriminim kategori të aftësive të kufizuara, si personat me aftësi të kufizuara intelektuale apo të dëgjimit, për të cilët nuk ofrohen lehtësira, por edhe për personat që nuk dalin dot nga shtëpia për të votuar, të cilëve aktualisht u mohohet tërësisht e drejta e votës.

Kjo situatë kërkon një përmirësim të shpejtë ligjor.

REKOMANDIME

Rezultatet e vëzhgimit në ditën e votimit për zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit 2013, në rajonet Tiranë, Durrës, Elbasan e Tiranë, diktojnë rekomandime për pjesëmarrje të plotë në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, përmes masave për të realizuar aksesin fizik të mjediseve e mjeteve të votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, si dhe për shërbime mbështetëse për të siguruar që të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që kanë vështirësi për të shkuar e për të marrë pjesë në votime, të mund të votojnë në mënyrë të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë.

Rekomandimet në vijim synojnë të ndikojnë në përmirësimin e situatës, duke dhënë orientime për përmirësime, si në drejtim të organizimit të shërbimeve parazgjedhore e zgjedhore për zgjedhësit me aftësi të kufizuara për identifikimin e tyre në lista, për informimit dhe ndërgjegjësimin e tyre për këtë drejtë, transportin e përshtatur për në qendrat e votimit, përzgjedhjen e [QV](#) të përshtatura dhe/ ose përshtatjen e tyre dhe pajisjen me mjete të posaçme votimi si dhe mundësi votimi për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia.

1. Të parashikohen përmirësime ligjore në Kodin Zgjedhor duke siguruar pjesëmarrjen në votim të drejtpërdrejtë, të barabartë e të fshehtë për të gjitha kategoritë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Kjo përmes përcaktimit të detyrimeve për strukturat përgjegjëse dhe ndarjes së qartë të roleve të tyre.
2. [KQZ](#) duhet të bëjë në mënyrë të përherëshme, në kohën e duhur, për do proces zgjedhor, planifikime buxhetore në një fond të veçantë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që të mund të përdoret për përshtatjen e qendrave të votimit, për prodhimin e mjeteve për të verbërit si edhe për prodhimin e dhomave të fshehtësisë të përshtatura.
3. Njësitë e pushtetit vendor të marrin masa për informim dhe ndërgjegjësim në kohën e duhur në periudhën parazgjedhore, të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, që të identifikohen në listat e zgjedhësve, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, për të parashikuar për ta dhe për të realizuar, në bashkëpunim me [KQZ](#), transport ditën e votimit, caktimin në qendra votimi të përshtatura, kërkesën për mjete të posaçme për të verbërit, dhoma të fshehtësisë të përshtatura.
4. Institucionet përgjegjëse- njësitë e pushtetit vendor në bashkëpunim me [KQZ](#), të marrin masa që [QV](#) të jenë të gjitha në objekte me hyrje të përshtatura. Për këtë:
 - të planifikohet ndërtimi i rampave në hyrje të objekteve me shkallë, ose të hiqen nga lista objektet me shumë shkallë dhe [QV](#) të tyre të vendosen në të tjera objekte të përshtatura
5. Shvendosja e të gjitha qendrave të votimit në katet e para (përdhe) të objekteve, ose të paktën, në bazë të informacionit të mbledhur nga njësitë vendore mbi shpërndarjen e vendbanimeve të personave me aftësi të kufizuara, të vendosin me prioritet qendrat ku ata votojnë në katet e poshtme të ndërtesave.
6. [KQZ](#) të marri masa në kohën e duhur, në periudhën parazgjedhore për përgatitjen, testimin, botimin dhe shpërndarjen në kohë të mjeteve të posaçme ndihmëse për të verbërit dhe dhomat e fshehtësisë të përshtatura;
7. [KQZ](#) të përfshijë në spotet publicitare edhe informacion të posaçëm për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, duke e shoqëruar edhe me gjuhën e shenjave. Me gjuhën e shenjave të shoqërohen edhe të gjitha spotet që [KQZ](#) realizon në periudhën parazgjedhore për ndërgjegjësimin e të gjithë zgjedhësve.
8. Të shihet me prioritet gjetja e zgjidhjeve alternative, përmes përmirësimeve ligjore, për votimin e zgjedhësve që nuk dalin dot nga shtëpia.